



Arber Shabanaj & jembiter-liber
Schriftsteller/Writer/Shkrimtar

Katalog

2022/2023



Të nderuar miq të letërsisë,

më lejoni, t'ju prezentoj veprën time të botuar. Është një ndër veprat e para në fushë të letrave, por jo e para vepër e jetës s'ime. Se një tjetër vepër, si një ndër komandantët e një njësie të UÇK-së në Kosovë, unë me shokë e kam shkruar gjatë luftës për liri.

Pra, ky është një dëtar i atyre ditëve të zjarra, kur rinia kosovare - e jo vetëm ajo - hodhi pushkën në sup, e japi edhe jetën, që të zbohej nga vatrën e ushtrisë serbe dhe liria të përflakte çdo zemër shqiptare.

Siç edhe do ta lexoni, libri ka shumë jetë, shumë dashuri e mbi të gjitha shumë vërtetësi. Detyra ndaj Kosovës së robëruar, me sakrificën sublime e heroizmin, janë të shkrira organikisht e bëjnë apel sidomos për brezat që do të vijnë; që kurrë, në jetë të jetës, të mos harrojnë kalvarin shekullor të Kosovës për të mbritur tek liria e pavarësia.

Si dëshmitar e protagonist i atyre viteve të zjarra, unë, si autor, nuk lë të paidentifikuar asnjë problem. Edhe pse mbajta në betejë flamurin e UÇK-së, edhe pse isha komandant i një njësie luftarake, e cila ka shkruar me gjakun e dëshmorëve historikun e saj të lavdishëm, unë kam kurajon të ngrisë zërin e të themë disa gjëra për komandën eprorë, se si disa punë e veprime duhej e mund të ishin bërë më mirë.

Gjithsesi unë, si komandant i ri në moshë, por jo në mendime, jamë krenar për çfarë kam bërë me shokët e mi.

Këtë, përmes faqeve të librit, lexuesi e ndjen - siç e ndjen edhe modestinë - se çdo kush, që kishte në deje gjak shqiptari, këtë sakrificë ia kishte borxh Atdheut dhe Kosovës.

Ngadalë kaluan dy dekada, qëkur Kosova është "e lirë", edhe pranverat e para kjo tanimë i celebron si "e pavarur". Në varret e të rënëve ka veç lule të freskëta. Kështu do të ketë në çdo stinë të vitit. Janë këto lulet e shpirtit të Kosovës, të cilat për të rënë nuk do të vryshken kurrë.

Të gjitha këto unë si autor i kam thënë e mendoj se kjo nuk është pak. Librin tim e karakterizon puna e ime profesionale në sferën e literaturës dhe këtë e shoqëron një gjuhë e lartë, e kulluar shqipe. Duke ditur se historiat e kombit tonë, shumë të çmueshëm shqiptar, tanimë nuk trashëgohet vetëm gojarisht, por fatlumësisht ky transferohet edhe me shkrim, kështu në veprën time janë të interpretuara në formën më të drejtë të vërtetës e pathëna, të cilat kanë ngelur në pluhurin e harresës. Por jam i bindur, se ky kapitull historik, kaq kapital, i emërtuar si panteon i një kombi, nuk lejohet kurrë që të tretet në pluhurat e harresës. Sepse vetëm kështu mundemi njëherë dhe përgjithmonë të mësojmë nga gabimet.

Libri përbën një kontribut jo të papërfillshëm për historikun e Luftës Çlirimtare të UÇK-së e të Kosovës martire dhe, si i tillë, ky do të çmohet nga lexuesit që do ta marrin në duar. Në vazhdim kam nderin t'ju prezentoj leximin provues të librit tim të sipërpërmendur - të botuar -, i cili titullohet "Lisi i gjakut" ("Kur fjalët vrasin"). Arber Shabanaj, prill 2023

ARBER SHABANAJ

**LISI I
GJAKUT**

Kur fjalët vrasin



Roman
Jembiter Liber

Arber Shabanaj

Lisi i gjakut

Kur fjalët vrasin

Roman

322 faqe

ISBN 978-3-7575-4278-8

19,99 EUR

Shtëpia Botuese „Neopubli GmbH“ / „Epubli“

10997 Berlin

1. Auflage April 2023

Kapitulli IV

Elshan, data shënonte 24 maj 1999, ora 21:30.

Ishte aq rrëmujë, sa që nuk arrij dot ta përshkruaj. Disa i kishte përfshirë mallëngjimi dhe s'e flisnin asnjë fjalë, veçse, kur i shihje si të përhumbur, të ngjanin se ishin në ëndërr. Duke ecur ashtu - as nuk ju bëhej vonë dhe as që ju interesonte dot se - fushin këmbët nëpër gropat e shumta, të cilat i ofronte terreni i atyshëm. Dhe vetëm i dëgjoje kur thonin „Hopa”, ngase, me gjithë përgatitjen ushtarake mbi supe, të ngjanin se zgjoheshin, pasi dikujt edhe i dhimbte këmba e lënduar ...

Disa të tjerë i kishin përfshirë emocionet dhe vetëm kur i dëgjoje se si me tërë forcën e zërit bërtisnin: „O shka, pritna se arritëm e na do ta nënën!”. Kurse një tjetër pjesë e ushtarëve, të cilën mundeshe t'a radhisje në kolonën e tretë, e kishte rrokur edhe paniku si edhe e kishte lënë koncentrimi në balltë. Këta ushtarë -, duke e këthyer kokën sa anash, sa para, sa mbrapa, dukeshin në lëvizje si qesharakë -, sikur t'ju kishte humbur busulla orientuese, pa ditur se çfarë donin e çfarë kërkonin, vetëm ulërinin: „Ma shpejt, ej, ma shpejt, po çfarë po prisni?!”. E vetë ata ishin edhe më të ngathët se breshka, kishin ngelur në vend dhe s'dinin nga t'ia mbanin dhe as se kujt i takonin! E në atë ecje hasje edhe prej atyreve, të cilët vetëm se donin të binin në sy. Mirëpo fati i tyre i keq ishte fakti, se ato marshime e luftëra më së shumti zhvilloheshin natën, në errësi, kështu që edhe nuk kishte se kush t'i shihte! ...

Më dukej se rrëmuja vinte duke u shtuar. E ndihesha edhe i brengosur pse ngjante ashtu, por edhe i gëzuar se togën time e kisha “top”, plotësisht në një hap e nën kontroll. Meqë në atë krahurë ecjeje, ishte sukses nëse tjetri nuk ta ngjishte automatikun në fytyrë, pasi, sikurse edhe në Burrel, ende disa automatikët i bartnin mu si bujqit atëbotë lopatat; pra mbi supe! Ndërsa tjetri, siç ishte më së miri, duke kaluar përskaj teje, thujse pësoi goditje epileptike -, përderisa ishte duke folur me tjetrin -, zgjaste duart deri në maksimum, duke i thënë bashkëbiseduesit me zë të lartë e nervozizëm: „Hajt, bra mos m'ladh allajle há”. E ty, për një fije, që duke t'a futur me tërë forcën gishtin në sy! Të këtitillëve nuk iu mjaftonte vetëm diskutimi, por iu duhej edhe artikullimi dhe gjestikulimi, thujse po i shihte ndonjëri në atë errësi.

Të gjithë ushtarët ishin të armatosur dhe kishin municion afër vetes. E kjo ishte edhe e rrezikshme -, nëse frikacaku bëhej me armë -, pasi jo vetëm nga pakujdesia, por më shumë nga ndonjë hije, e cila kishte mundësi t'i shfaqej diku papritmas, edhe mundte t'a shkrepte armën pa e pasur të ditur se do të vrisje shokun përpara. E tipat e këtitillë veçse frikacakë (sa mirë që në rreshtat tonë ne nuk kishim shumë nga këta), kishin mbetur edhe adoleshentë, edhe pse moshën e pjekurisë qëmoti e kishin kaluar. Madje Drenica për këtë specie njerëzore e ka një thënie kuptimplotë: „Janë disa njerëz, të cilët i bëjnë edhe 50 vite e nga faza e pjekurisë nuk dalin!”.

E kështu edhe disa nga këta ushtarët e UÇK-së vetëm se i kishin mbushur armët.

Ishte aq errët sa s'mundje as këmbën tënde ta komandoje se ku do ta hidheje. Megjithatë, hera-herës dalloja disa nga ushtarët e togave të tjera, të cilët ishin me cigare në gojë, me një rën dorë në automatik e me tjetrën duke rrotulluar bajonetën si të ishte ajo lodër! Sigurisht që këta ishin ata, të cilët në Burrel më së shumti rinin përfundi hijeve, përdërisa neve na shkonte djersa - në stërviçe - për lug të shtatit! Po nëse nesër në front këta e humbnin rrugën, mua më duhej t'i merja me vete, si ushtarë të mi, në mënyrë që pakujdesia e djeshme, këtyre, të mos ju kushtonte nesër me jetën ...

Ecja edhe unë përkrah ushtarëve, me rreth 30 kilogram peshë mbi supe ...

Diku përtej, po na prisnin automjetet për transport.

Unë kisha arritur në bindjen se nuk do të kishte qenë aspak e vështirë të organizoje një ushtri, nëse punoje me sistem dhe secili epror do të kishte kryer punën e vet. Kurse në ato çaste ndiheshe i lumtur nëse ushtari i dikujt tjetër s'të përzihej me ushtarët e tu, pasi sa herë që kjo ndodhte, të lindnin probleme nga më të ndryshmet. Dhe kjo vinte nga fakti, se ai ushtari tjetër nuk kishte kurrfarë koordinate që të orientohej e madje nga ky çorientim kishte mundësi të lindte ndonjë rrëmujë e madje edhe ndonjë panikë. Sepse ne shqiptarët më së shumti jemi rritur duke na qortuar dhe trembur, psh: „Ruaju këndeje, ruaju andej”, „Ruaju se po digjesh ... se po të rreh ndokush ... se po të ha gjarpëri ...”. E

në atë rrëmujë, e cila sa vinte e rritej para meje, një zë i egër, fort i lartë, zë komandues - „Ma shpejt, ma shpejt, ma shpejt, çka po pritni, bre!” - , të irritonte nervat, pasi që orientimi i drejtë do të ishte dashur t'ju jepej me kohë ushtarëve e jo tani, kur gjithçka në atë marshim, vetëm se ishte bërë 'lesh arapi'. Ishte ai zëri i komandantit “Daja i vogël”, i cili me ato veprime e fundoste edhe më thellë titanikun e mendjes, së atyre ushtarëve të papërgatitur sa do të ishte dashur, në oqeanin e pasigurisë.

E para, ne si ushtri, ishim fare të pangrënë. Tërë kohën u ushqyem dhe po ushqehshim nga banorët civilë, të cilët, si në Burrel, ashtu edhe aty na shisnin artikuj ushqimorë dhe koleksione pijesh, duke jua zbrazur xhepat ushtarëve.

E dyta, kishte plot katër netë (po flas për vetën time së pari dhe për ushtarët e mi), përgjatë të cilave ne nuk kishim fjetur më shumë se 2-3 orë!

Kështu që nëse i zoti i shtëpisë do, që të gjithë anëtarët e familjes t'i afrojë në një tryezë, atëhere ky edhe duhet t'ju afrojë atyre diçka të shijshme. Eprori i dobët vetëm se i denigron dhe i determinon ushtarët e vet. Me të gjitha ato çfarë ky epror ju kishte ofruar ushtarëve të vet, a e meritonte vallë që ky të sillej me ne asisoj? Falë Zotit që ekzistonte Kosova, se po të mos kishte qenë Kosova e jonë, për këso eprorësh askush nuk do të kishte luftuar! Por do të luftojmë për hir të saj dhe të kosovarëve të shumëvujtur, që nesër edhe për këta të zbardhte një ditë e re! Që të mos ketë më viktimë, një pjesë e të cilave, për mendimin tim, janë shkakuar ngase neve

kosovarëve na ka udhëhequr i pazoti me dekada të tëra. E di se edhe në të ardhmen do të shkaktohen viktima, nëse do të na udhëheqë edhe më tutje një njeri që nuk e meriton. Dhe kështu Kosova vetëm se do të ndërroj ngjyrat (!!!) e jo profilin e saj! ... Kështu, edhe këta ushtarë, të cilët nga mungesa e ushqimit dhe e fjetjes ishin aq të lodhur dhe të cilëve ngarkesa që kishin mbi supe jua kishte këputur leqet e këmbëve, nesër mund të shndërroheshin lehtësisht në viktima nëse eprori nuk krijonte hapësirë që këta të ripërtërinin forcat. Shumë nga këta eprorë të pakualifikuar, vërtetë të kategorisë së Isait, ishin imitatorë të pashoq. Këta janë trajtuar vetë dikur kësisoj dhe kanë kopjuar shumë nga shkijet. Për këtë ju betohem në mëngjes, në mesditë, në mbrëmje, gjithnjë! Besa eprori shka i ngop ushtarët e vet me bukë, në çfarëdo mënyre që kjo edhe të jetë e nevojshme. Ngase një epror - pa ushtarët e tij - shndërrohet në zero, ndaj edhe unë, që të ndihesha, veten e llogarisja kurdoherë në mes të ushtarëve. Ata më trimëronin, m'a ngrohnin shpirtin, m'a largonin mërzinë dhe më dëgjonin e nesër edhe do të më ruanin. Për këtë unë edhe pata investuar një punë të vazhdueshme ...

Pas një udhëtimiti jo fort të gjatë, ne mbërritëm në Krumë. Disa e shijuan këtë udhëtim të fundit, pasi në luftë ata ndoshta edhe do të binin për Kosovën!

Më pikonte zemra gjak, qaja pa lot, kur mendoja se; të biesh në luftë është pavdekësi, por të biesh viktimë e eprorëve të paaftë është tragjedi!

Ca banorë të atyshëm, edhe pse ishte mesnatë, kishin dalur nëpër dritaret e shtëpive të tyre dhe shikonin se si luftëtarët e lirisë po shkonin drejt frontit të luftës.

Ishim fort të lodhur. Disa ishin të lodhur aq shumë, sa që edhe hapin e hidhnin kuturu.

„Ma shpejt, ma shpejt, ma shpejt! ... Po çka po pret ti, aaaa?“, një zë i çartur ia prishi sërish momentin solemn asaj mbrëmjeje. Dhe një tingëllimë që i ngjau një “shpllapi” dëgjoi përnjëherësh veshi i secilit nga ne. Ishte ky komandanti “Daja i vogël”, i cili e goditi me shpullë njërin nga ushtarët ... E pse? Sepse ushtari i pafajshëm mezi po ecte ...

Veprimi i tij, edhe pse i maskuar nga errësira, u kuptua nga të gjithë ne sa qemë rrotull e, edhe pse të gjithë ishim të armatosur, heshtëm për një çast. Heshtëm sepse nuk deshëm t’ a besonim se një gjë e tillë mund të ndodhte, e cila u shfaq si një rrufe në Qiell të pastër. Na u duk se heshti edhe i gjori ushtar, i cili ra viktimë e ligësisë së këtij burracaku që vetëçuhej komandant ... Harroi zotëria e tij, se ne në mesin tonë kishim edhe vajza, të cilat ndiheshin keq e mundnin edhe të pësonin trauma kur shihnin skena të atilla kundër një luftëtari të thjeshtë lirie!

Për mua personalisht, incidenti i komandantit me këtë ushtar që i padenjë. Se nëse këto veprime shumëzohen, atëhere unë kam të drejtë të mendoj se eprori i lig është në gjendje që të shkrijë një armatë të tërë, vetëm që nesër të marë për vete medaljen e gjakosur me gjakun e dëshmorit ... Se ky ushtar që u godit, mbase nesër do të binte në fushën e luftës, mbase nesër ai do t’ja shpëtonte edhe jetën eprorit të padenjë ...

Mendimet m’i davariti urdhëri që erdhi për marshim. I rreshtova ushtarët në njëshkolonë dhe u nisëm. Tani as nuk të urdhëronte ndokush e as nuk të informonte fare mbi orientimin gjeografik, mbi terrenin se ku ne gjendeshim. U mjaftuan vetëm me ne - eprorët -, kur na thanë:

„Kjo është rruga, asaj t’ja mbani, derisa të ngjiteni në maje të asaj kodre. Atje është vija e frontit, aty gjindet edhe pika e jonë, prej nga ne do të hyjmë në luftë. Menjëherë, mbrapa asaj kodre, është Kosova“, ishin këto fjalët e eprorit tanë të lartë, i cili më pas e uli prapanicën e tij në makinë dhe me të po i ngjitej asaj të përpjete!

Shpjegimi i cekur nuk ishte i mjaftueshëm as në planin gjeografik e as në atë ushtarako-strategjik. Ishte aq i cekët, thuajse ne gjithë jetën të kishim ruajtur delet këndeje, që ta njihnim terrenin aq kënaqshëm! Ah, o Zot, përgatitja serioze individuale e secilit është alfa dhe omega për të udhëhequr në

shtigje të sigurta të tjerët, por në këtë rast?! ... E sakaq më vinin parasysh fytyrat e oficerëve nga Shqipëria, të cilët na u vunë në krah në stërvitjet tona në Burrel. Me siguri që me ata, punët do të kishin shkuar edhe më mirë e ne nuk do t'i kishim këto të meta.

Tani ne ishim në luftë. E gjithkush e kupton se këtu - vetëm një dobësi e vogël të ekzistojë në komandë -, ushtarët bëhen viktima!

Mbas pesë orësh e gjysëm marshimi, arritëm në majë të bjeshkës, në pikën e takimit. Kodra të ngritura, aty-këtu ca shtëpi përdhese të banorëve të atyshëm, të cilat më së shumti ju ngjanin kasolleve. Përballë nesh ishte rruga, e cila të shpinte tek një luginë pakë më e rrafshët. Gjithandej terreni mbulohej nga shkurret, nga shkëmbinjtë e ashpër dhe nga ca gurë të mëdhenj pa kurrfarë jete bimore përreth tyre.

Ishte agu i ditës së re. Drita buronte nga Qielli dhe e bënte më të dallueshëm gjelbërimin e atyshëm. Me siguri se aty edhe kullosnin bagëtia. Ishte ky një reliev tipik i një bjeshke. Përballë nesh ndodhej një shtëpi, e cila i ngjante ca kullave të vjetra shqiptare. Ishte dykatëshe. Përskaj saj një ndërtesë përdhese. Pak më tutje një kasolle fare e vogël, mbase për strehimin e kafshëve.

Para ndërtesës më të ngritur dalluam një makineri ushtarake të parkuar aty dhe, çuditërisht të pa maskuar. Askund nuk dalluam ushtarë, të cilët do të duhej të bënin roje!

Në pikën e takimit nuk ishte askush nga shtabi që të na priste e të na orientonte. Megjithatë vepruam vetë me vetëiniciativë: Me kujdes hymë në atë ndërtesë. Në një dhomë fort të ngushtë, pamë një dritë të ndezur. Aty vendosëm edhe të futemi. Brënda vinte era qumësht! Aromë fshati e bagëtie. Plot e përplot kosha buke, të renditur njëri mbi tjetrin. E ne, prej kohe me barkun bosh, “sulmin” e parë e bëmë mbi bukën, që në atë çast na shijonte më shumë se çdo gjë tjetër! E ashtu, si edhe tek gurra e ujit të bjeshkës -, si të babëzitur po e hanim edhe bukën thatë -, do ta boshatisnim shumë shpejt

tërë koshin, duke e ditë se ishim gjithë ata burra dhe duke shpresuar se po mernim kështu “hakun” e disa ditëve ... E mua, në atë moment m'u kujtua “Poema e mjerimit” e Migjenit ... Veç t'a shihnit atë skenë, kur ushtarët panë bukën e të bindeshit se ç'vlerë mbart ajo për njeriun! ... Në atë çast unë kam parë një ushtar t'a përkëdhelte bukën, një tjetër t'a puthte ... Meqenëse ajo e kishte emrin jetë!

E ndërkohë që kështu po meditoja, dëgjova:

„Vallaha kushat e mi buka osht për starashinat, po nejse, s'ka gojle, hani ju, hani! Kapak vç, a nit?”

Ajo gjuhë e rëndë është e domosdoshme të kuptohet në Shqipëri e pastër kështu: „Shokë të nderuar, buka është për eprorët, por ju mundeni të hani nga pak. Vetëm nga pak, dëgjuat?”

Të gjithëve na ra rëndë në vesh fjala “starashinat”, që ky ushtar e tha më parë ... Kjo ishte puro fjalë serbe e me këtë ai përcaktonte eprorët. Edhe ky, i cili na fliste kështu, ushtar ishte - si ne -; e kishte uniformën dhe emblemën tonë, të UÇK-së dhe e çuante domosdo veten luftëtar ... As më shumë e as më pak, për mua, kjo identifikohet kështu; një copë Jugosllavi në radhët e UÇK-së!

Me ardhjen e tij, nuk patëm ne mundësi të hanim më tepër se 3-4 fletëza buke, edhe pse, kuptohet, thatë. E ai, i cili na e bëri atë lëshim, që të hanim pak, pra kuzhinieri, na premtoi se nesër do të kishte bukë edhe për ne. E ti e pyesje veten: Por kur është nesër sipas këtij? Ishim në kufinj të orës gjashtë të mëngjesit të asaj dite të re e ti porsa kishe mbërritur nga

marshimi i gjatë dhe këta t'a thoshin fjalën tronditëse "Nesër"

...

Kishim dalë përjashta dhe po vëzhgonim se mos në atë farë terreni gjenim një vend sa për të futur kokën e për të bërë një sy gjumë. Shtëpia më e lartë ishte krejtësisht e mbyllur. Edhe ndërtesa që i ngjante një magazine ishte e bllokuar. Vendosëm të shkonim në atë të voglën fare, e cila mundte të kishte qenë e destinuar për bagëtitë. Dera aty mungonte, ishte si një farë trine e mënjanuar, e cila tregonte se më parë me të ndrynin natën bagëtitë. Akoma pa u afruar sa duhej, vinte era e rëndë e bajgave.

„Çfarë, çfarë ore? Çfarë? Ku-ku, o Arber! Eja këtu!”

Arsimi dhe Beslimi pothuaj njëzëri m'u drejtuan, thuajse aty hasën në Anakonda apo në Boa!

Buzë plehut të bagëtive, ca mbi kashtë e ca mbi tokë, shtriheshin në gjumë kushedi sa ushtarë ... Pak më tej, jashtë kasolles së bagëtive, të shtrirë për tokë, kush mbi ndonjë fletë mushamaje e kush mbi bar, me dhjetëra ushtarë të tjerë në kokërr të gjumit, që i kositje me një breshëri automatiku. Një skenë të atillë nuk e kisha imagjinuar dot! Nga lodhja, shumë flinin me fytyrën drejt Qiellit, me pushkën afër kokës, dyst me tokën, po flinin pa dëgjuar fare, thuajse të ishin të vdekur! Në mesin e tyre kishin depërtuar edhe disa nga ushtarët e mi, të cilët kishin mbërritur më herët aty ... Aty ku serbët tani i kishim përballë - diku -, në pritje të reagimit tonë ...

Nuk e di, por ndërsa po vëzhgoja dhe nuk po shihja rrezikun e ndonjë sulmi eventual të armikut, terreni ardhke e më mjegullohej dhe për një moment -, shpirt është ky -, ika edhe unë përtokë mbi "krevatin" tim shkëmbor. Më vodhi edhe mua gjumi ...

Ngaqë nuk e kisha kontrolluar dot veten kur u shtriva aty, në gjoks e në shpinë ndieja një dhimbje, sikur dikush më ngjeshte që të më jepte frymëmarrje artificiale. Brinjët më dhembnin gjithashtu fort. Siç dukej, tërë atë kohë që kisha fjetur, kisha pasur përfundi gjoksit tim një gur të thepisur. Qafa më ishte ngrirë, ndërsa kokën e ndieja jashtëzakonisht të rënduar!

Përrreth teje dëgjoheshin ca ulërima, që ju ngjanin atyre çavkave, të cilat porsa i kishin rrëmbyer pamëshirshëm zogun pulës. Tërë kjo të dukej si gjysmë ëndërr. Por jo! Ky ishte krejtësisht një realitet. Pra, po na zgjonin, se "komandanti" paska urdhëruar të rreshtoheshim. I gjithë terreni të ngjante sikur të ishte një plantacion i mbjellur me ushtarë. Gjithandej dëgjoje gjëmimin dhe ofshamën e këtyre të shkretëve, të cilët, në ato momente, më mirë do të kishte qenë të krahasoheshin me robër lufte se sa me ushtarë të lirisë!

„Oh, nënë, po më çahet koka nga dhembja!”, dëgjoje thuajse të ankoheshin të gjithë.

Sidoqoftë tani - u ankove e s'u ankove - ishte e njëjta gjë.

Ishte ora 09:20 minuta. E shumta kishim fjetur tri orë. Ndërkohë që eprorët e shtabit të atyshëm, por edhe ata të

togjeve të tjera, kishin fjetur në atë shtëpinë më të lartë e jo me binjë në tokë! Bashkë me ushtarët dhe ashtu sikurse edhe ushtarët paskëshim fjetur vetëm Avniu, Ahmeti dhe unë.

Askund përrreth nuk kishte ujë për të pastruar fytyrën, as 'wc' dhe asnjë kusht tjetër.

Vetëm kur u ngrita e kuptova gjendjen time. Këmbët më ishin ftohur aq shumë, sa që edhe më ishin mpirë e nuk i komandoja dot me shpejtësinë që e kërkonte urdhëri i dhënë.

Por të gjitha këto i shkruftoj në çast një predhë, e cila fluturoj diku tej.

Serbët, po nisnin kështu të granatonin me artileri të rëndë drejt pozicioneve tona. Predhat shpërthenin sa majtas, sa djathtas, sa përpara. Por kishim vetëm fat, që në atë sulm, ato nuk shpërthenin pranë nesh. Na ruajti Zoti, na ruajtën vuajtjet tona të shumta e s'na arritën predhat, jo vetëm kur ne po flinim, por edhe ashtu përderisa ne krejt të zbuluar ishim! U bëmë njësh me tokën; kush pas një shkëmbi e kush në ndonjë gropë, për t'i ikur ashtu sa më shumë rrezes së veprimit të atij granatimi. Pasi ti nuk e dije se ku përplasej predha, vetëm e dëgjoje fishkëllimën e saj të kobshme "psssfshiuuu" përgjatë fluturimit...

Kur granatimi pushoi, u ngritëm me kujdes, mblodhëm forcat dhe përgatitjet tona luftarake dhe u nisëm drejt vendrreshtimit.

Togën time e rreshtova në luginën pak më të rrafshët, sipas renditjes së kompanisë dhe TF-it tonë, meqenëse e kishim urdhërin për rreshtim. Të gjithë ishim të rreshtuar, me

sytë e fryrë nga pagjumësia dhe lodhja, por edhe nga mungesa e ushqimit. Shikime që "flisnin" e "vrisnin". Këta ishin pra ushtarët luftëtarë.

Përrreth stacionimit tonë ushtarak, ishin vendosur dhe renditur disa nga banorët e atyshëm. Ashtu si edhe gjatë, edhe ata shisnin produkte ushqimore e lëngje të ndryshme. Ca të tjerë donin të përshëndesnin zbarkimin e këtyre krijesave në kopshtin e ... çudirave, zbarkimin tonë! Por tani, të uritur tmerrshëm dhe me xhepat e zbrazët, nuk ishim më në gjendje të blinin asnjë kanoçe me 'koka-kola'...

Përballë rreshtimit tonë të përgjithshëm qëndronin kaq shumë të ashtuqajtur "komandantë", të cilët as që i kishim parë ndonjëherë me sy të ballit duke stërviur apo duke drejtuar njësitet tona. Me numrin e tyre do të plotësonte njeriu lehtë një togë tjetër, të cilën do e stërvisja unë pa përtesë... Më vinte keq për ushtarët që ishin të detyruar të qëndronin në këmbë para tyre! Ishin të lodhur dhe vërtetë nuk kishin mundësi kot së koti të qëndronin aq gjatë në këmbë. Sidomos Shemsiu dhe Astriti (ushtarë të togës sime) ishin të revoltuar dukshëm. Sa që Shemsiu s'iu durua më dhe kërkoi bukë me zë të lartë.

„Azemi ka duruar një javë pa bukë”, iu përgjigj pa iu skuqur aspak fytyra njëri nga eprorët Shemsiu, i cili në fund të fundit bëri një kërkesë elementare e të cilën eprori ishte i detyruar t'ia plotësonte.

„Kush Azem, ore?“, ndërhyri Astriti nga rreshti, por me zë të fortë, që të dëgjohej nga të gjithë, pasi u revoltua sa s'kishte nga përgjigja që eprori ia dha Shemsiut.

„A e di ti se për kë po flet, more kastravec?!“, ia ktheu ky Astritit të shkretë.

Në mënyrë që të evitoja ndonjë incident edhe të armatosur mes veti - akoma para se të futeshim në luftë -, m'u desh të ndërhyja:

„Astrit, Shemsi! Mjaft më, mjaft!“, iu drejtova ushtarëve të mi të pafajshëm, ndërkohë që iu afrova eprorit dhe i thashë:

„Zotëri, me ushtarët e vet, me luftëtarët e lirisë nuk sillet një epror kësisoj. Ne e kemi kundërshtarin përballë, në front dhe s'kemi kohë të zihemi mes veti. Të mos e lëshojmë veten kaq poshtë e t'ia bëjmë qejfin armikut!“

Nuk e di, por ndërhyrja ime e dha efektin e vet. Megjithatë sa pushova unë, nga rreshtimi u dëgjua një zë tjetër:

„Qen bir qeni! Shka i poshtër!“

Mbase situata kishte mundur të eskalonte edhe më tej, sikur të mos ndihej një granatim diku larg rreshtimit e të na kujtonte të gjithëve se armiku po na priste. Në pauzën që u krijua pas granatimit, Isai u përpoq të thoshte diçka, por atij ia mbyllën gojën ushtarët dhe ai nuk bëri më as mëk e as gëk.

Sërish shkijet herëpashere me koordinata mesatare hidhnin predha artilerie nëpër stacionimet tona, pra këtej kufirit, në territorin e Shqipërisë.

Përballë nesh sërish qëndronin këta eprorë të lartë, të cilët mbrëmë - si edhe për natë - kishin fjetur butë dhe e kishin

ngrënë bukën e rezervuar enkas për ta! Seç e kisha një bindje, se nesër ata do të ngriheshin në emër të këtyre ushtarëve, të cilët i trajtonin si robër lufte e do të thoshnin se paskëshin qenë gjithnjë përkrah tyre, në ditë të mira dhe në të vështira. Eprorët e kalibrin të këtyllë po ma shpifnin aq shumë, saqë më ndillnin pesimizëm: Se si me këta ne do ta fitonim luftën.

Pas pak u shpërndamë nga vendrreshtimi, i cili, më shumë se kurrë - e sidomos tani që po granatonte serbi -, ishte i gabuar.

Po prisnim me shpresë së do të hanim diçka dhe nga një magazinë e atyshme të kompletoheshim përfundimisht me armatim dhe me municion.

Nëpër terrenin përplot me gropa, gurë e shkëmbinj ecnim dhe - ngase të pafjetur dhe të uritur -, shpeshherë nuk ishim në gjendje as hapat e të ecurit t'i koordinonim. Sepse, thjeshtë, na mungonte energjia. Ndoshta dikujt tjetër, nga kjo gjendje, do t'i kishim ngjarë si “pula pa krye” ... Por jo, ne ishim ushtarët e lirisë dhe të tillë do mbesnim deri në fund e s'do të jepnim veten para asnjë vështirësie!

Ishte rrëmujë e madhe momentalisht: Ofendonin, bërtisnin me zë të lartë dhe shpeshherë flisnin disa veta përmjetherësh!

Fshati aty, ku ne ishim të stacionuar thirrej Pogaj dhe gjendej në afërsi të Krumës. Ishte krejtësisht në kufi me Kosovën, kurse kjo ishte edhe zona e Hasit të Shqipërisë. Papritmas një aromë dehëse e tërheqëse shpërndahej gjithandej. Një shikim i cili na zgjoi pothuaj optimizmin. Ishte aroma e ushqimit. Aroma e suxhukut të Kosovës që po piqej

mbi prush në atë kuzhinën e ngushtë të shtëpisë më të lartë. Ju betohem, të gjithë iu afruam erës së tij dhe asaj shtëpie. Dhe ky veprim u bë instinktivisht. Nga aty ku isha, dalloja plot e përplot “zorë” suxhuku, të vendosura njëra mbi tjetrën. Shihnim edhe njëherë ata koshat e bukës, të cilët i pamë në mëngjesin e asaj dite ...

„Ikni, largohuni prej këtu. Këto nuk janë për ju, janë për komandantët!”, u dëgjua egër zëri i çjerrë i një ushtari me rroba të UÇK-së, i cili, ashtu siç edhe ishte, dukej se na i gërryente edhe më shumë zorret tona që ishin bërë petë. Ky djalë, i cili na e kishte vënë pritën, ishte një ndër të shumtët kamarierë-balerina të eprorëve kosovarë të atyshëm, i cili e kishte guximin t’ju thoshte kështu luftëtarëve të lirisë! I dëbonte me fjalën e vrazhdë, si të ishin këta kalamaj, të cilëve ju mbetej syri tek ajo që s’e kishin. Ndërsa ushtarët, duke mos dashur të fëlliqeshin e ta shisnin veten lirë para bishave të atilla, largoheshin të dëshpëruar duke shfryrë me sa mundnin. Shumica prej nesh veçse e imagjinonim e nuk e dinim saktësisht se çfarë fshihej pas mureve të asaj ndërtese ...

Nuk e dija përse, por një instinkt i brendshëm më thoshte se aty ishin të strehuar ata të policisë ushtarake me disa nga eprorët e atëhershëm, të cilët realizuan aktin e turpshëm ndaj meje e shumë aktivitete të tjera të ndyra në Burrel. Dhe nuk isha unë i vetmi që mendonte kështu. Edhe disa të tjerë e kishin nuhatur këtë. Por edhe ne të gjorët, vallë në çfarë të mendonim më parë?!

Edhe pse qëkur u shpërndamë nga rreshtimi ishte në fuqi urdhëri i armatosjes së secilit njësit dhe të ushtarëve në përgjithësi, prapë se prapë ai mbeti në eter, nuk zbatohej. Eprorët u ngujuan në ndërtesën e lartë dhe me siguri se atje po hanin e po pinin, kurse ushtarët bredhnin përreth akoma të uritur, si endacakë ...

Shumica nuk rezistonin e flinin si kuajt, në këmbë. Të tjerët gjenin një vend e shtriheshin. Edhe mua për një çast më vodhi gjumi ... Thjesht sërish plantacion i mbjellur me ushtarë: Ishim shtrirë mbi tokë e mbi gurë.

Edhe pse armiku granatonte diku përtej, askush nuk mundte të të garantonte se ai nuk e rregullonte shënjestrën. Gjithsesi ushtarët po vinin e mësoheshin me vërshëllimat dhe gjëmimet e granatimeve, saqë një ushtar më tha se tani ‘ato atij po i dukeshin si një orë me zile’!!! Të dukesh se graviteti i tokës kësaj here kishte një forcë tërheqëse të jashtëzakonshme, meqenëse me dhjetra e qindra ushtarë ndodheshin të shtrirë njëri pas tjetrit, domosdo duke bërë edhe kujdesje që të ishin pas ndonjë shkëmbi apo ndonjë lisi, që të mos i përfshinte granatimi.

Pogaj ishte bjeshkë. Duhma e luftës kërkonte të mundte aromën dehëse të çajit të malit e të rigonit, i cili përgjatë urisë që na kishte pushtuar, na e kujtonte picën! E për pak të shkonte mendja të haje barin apo ndonjë lëvozhgë peme, si dikur të parët tanë në luftën kundër turkut ...

Rreth orës 14:00: Një zë i egër apeloj për një rreshtim të ri. U torturuan edhe njëherë këta ushtarë të pafjetur e të pangrënë.

Mbase në gjumë edhe isha djersitur, si pasojë edhe kisha nisur të kollitem, saqë ajo kollë e thatë ndonjëherë vetëm se nuk m'i shkulte mushkëritë. Megjithatë i jepja kurajë vetes se kjo do të kalonte e nuk do t'më shfaqej bronkiti i hershëm. Le të shfaqej kurdo, por jo tani kur e kisha përballë armikun!

Edhe pse granatimi i armikut vazhdonte me pauza, barinjte e atyshëm - siç dukej ishin mësuar dhe - tani e parë rrinin duke jua ndërruar vendin bagëtive të tyre. Dhe neve na shihnin me një sy të habitur, pasi në gjendjen e sflitur që ishim, mbase iu ngjanim jo si UÇK, por si banorë të ndonjë planeti tjetër!

Ndërkohë kishte ikur ora në 14:30 deri sa u realizua rreshtimi ynë ushtarak. Të gjithë ushtarët kishin ngelur si memecë, vetëm shihnin si hije dhe s'flisnin dot asnjë fjalë. Sepse secili ndiente diçka të kobshme në brendësinë e vet, pra në atë gjendje katrahurë, në të cilën edhe arma mundte të fliste ... E sepse ishin shqiptarë me vepra dhe me zemër, edhe nuk e donin një gjë të atillë!

Përballë magazinës ushtarake unë rreshtova edhe ushtarët e mi. Po kompletoheshim përfundimisht me armatim luftarak. Mereni me mend, edhe këtu - në frontin e luftës; ku jeta në çdo moment mundte të takohej me vdekjen -, matrapazi mundohej të bënte "tregti". Ngase për disa togje shpërndaheshin vetëm 2700 fishekë, të tjerat nuk e dija se si

po arrinin të mernin 7000 copë! E të bëje pjestimin në togën time dhe në shumë togje të tjera, atëherë i takonte që në efektivin prej 30 vetash, unë të kisha nga 90 fishekë për çdo ushtar! E çfarë do të bënte vallë ushtari (sidomos fillestarët) në një luftë të këtillë me 90 fishekë gjithsej? ...

Nga shtabi erdhi një urdhër disi i çuditshëm, me të cilin disa zona - aty, ku ne ishim të stacionuar -, i shpallën si të ndaluara! Në kuptimin tonë se medemek aty do të kishte granatime nga armiku, ndërkohë që para një ore e gjysëm ushtarët flinin në ato zona për shtatë palë qejfe. Por ç'ti bëje! Kështu ngjante në shtabin e komandës sonë; dikush i binte gozhdës e dikush patkoit, apo, edhe ndryshe: Donin të na largonin neve sa më larg nga ndërtesa-“kështjellë” e tyre!!

Ndërkohë nëpër njësi, secili epror ishte i zënë me ushtarët e vet dhe këta së bashku angazhoheshin rreth armëve, gjendjes individuale etj. Kështu edhe pjesa dërmuese e terrenit të atyshëm ishte e zënë! Kishte ngelur vetëm “zona e ndaluar” të shfrytëzohej ...

Vendosa që - unë me togën time - të spostoheshim e të shkonim në fushën me gjelbërim, ku barinjtit e atyshëm kullosnin bagëtitë.

Përgjatë terrenit të asaj bjeshke takoj hapësirë të rrafshët, e cila përbëhej e shumta prej disa metrash, kurse pjesa tjetër ishte gropë, me të tatëpjeta e të përpjeta.

Ushtarët u nisën përpara dhe po zinin vend. Po mereshin me municionin dhe me përgatitjen e çantës individuale, thuajse kishin harruar se kishin plot dy ditë qëkur nuk kishin ngrënë.

Ndërsa po shkoja drejt togës, takova Safetin, i cili po mirej me ushtarët e vet. Siç edhe ju kam informuar, Safet Peci, ndërtoi në Burrel pas meje njësinë speciale dhe ishte tanimë epror i saj. Kishte një fizionomi të qartë luftëtari të UÇK-së dhe, krahasuar me disa eprorë të togjeve të tjera, ky nuk ishte

llafazan. Ishte serioz dhe punët i kryente siç duhej. Por vetëm se kishte dëshirë të madhe të binte në sy! Kjo edhe ishte dobësia e tij.

Më ndaloj teksa po kaloja përkaj togës së tij.

„A e vërejte se si mundoheshin t'i vidhnin armët dhe municionin e të tjerëve, Arber?“, më pyeti ai.

„Epo hajdutit i ka borxh edhe mbreti“, ia ktheva unë me humor.

„Nuk e di, Arber“, m'u drejtua sërish, „por një ndjenjë nga brenda më thotë, se kjo betejë, më tepër do të jetë beteja e jote dhe e imja, e ushtarëve të thjeshtë ...“

Po thoshte një të vërtetë. Lufta po zbriste në bazë, tek njësitë tona dhe duhej të ishe qorr të mos e shihje hendekun që po thellohej ndërmjet ushtarëve të thjeshtë dhe shtabit të atyshëm.

„Safet, ruaji ushtarët sa të mundesh ... Ti po e sheh, se eprori i aftë po shpërfillet haptas“, ia ktheva unë shkurtimisht dhe e vazhdova rrugën drejt ushtarëve të mi.

Në luginën e asaj kodre paksa më të ngritur, mbi barin e njomë ishin ulur ushtarët duke më pritur mua. Më ngjante se aty ishin më të sigurt. I ftova të vinin më pranë meje. Papritmas një zë i panjohur n'a tërhoqi vëmendjen:

„Largohuni nga aty, ore, ajo është e vetmja kullosë për bagëtinë time! Mos e shkëlmi barin!“

Pamë se jo larg nesh, i tensionuar po na fliste një çoban. Ushtarët e mi, herë shihnin nga unë e herë nga ai. Mbase edhe nuk e besonin, se ai e kishte seriozisht, pasi që kullosë

mundte të gjente edhe gjetkë. Pra, e kuptova se ku donte të dilte bariu, ndaj, në çast nxora nga çanta ime një palë pantallona dhe me ta në dorë po i afrohesha “pronarit” të asaj qetive:

„Janë origjinale, më kanë kushtuar 280 Marka Gjermane dhe nuk i kam veshur asnjë ditë! Supozoj se e ke numrin e njëjtë me mua. Janë pantallona të forta dhe moderne. Ushtarët vërtetë po t'a shkelin barin, por nuk po e hanë dhe nesër bari do të çohet përsëri. Na lër ca orë të qëndrojmë këtu me ushtarët, para se të futemi në luftë ...”

la dhurova pantallonat vetëm e vetëm që të na linte të qetë në kullosën e bagëtive të tija. Porsa i mori pantallonat, ai u largua dhe nuk bëri më as “e” e as “be”. E unë iu afrova sërish ushtarëve të mi. Disa u çuditën, se si më shkoi në mendje një gjë e tillë, të tjerëve iu dhimbseshin pantallonat, të cilat qenë me të vërtetë të bukura ...

Shenjat po bëheshin gjithnjë e më të qarta; se ne po futeshim në luftë. Ndaj si epror i tyre, mu ashtu si edhe më takonte, po merja masat e fundit. Po e kontrolloja përgatitjen e deritanishme.

Edhe pse të lodhur deri në limit, ishin të koncentruar. Puna dhe zellshmëria ime ishin shpague. Ushtarët e mi ishin të gatshëm për luftën. I organizova dhe i instruktova edhe sanitaret dhe bartësit e të plagosurve. Ju shpjegova se edhe

kundërshtarët mundnin të e dinin gjuhën Shqipe, mundnin të ishin të veshur edhe me rroba të UÇK-së e mundnin të na ngrinin edhe gracka të ndryshme. Dhe çfarë ishte me rëndësi; shkijet kishin traditë ushtrie e luftime, kështu që nëse gjatë luftimit ata neve do t'na provokonin me intervale të shkurtra zjarri, ne duhej gjithsesi të e kishim parasysh se me atë provokim ata do të donin të na shtynin neve të shpenzojmë municionin tonë pa kriter. Pra ta kursenim municionin dhe ta shpenzonim vetëm në momentin e duhur për të asgjësuar forcat e gjalla të kundërshtarit, e jo për të bërë demonstrim force. Sepse, po ngelëm pa municion, atëhere ne disfatën do t'a kishim tek dera.

I porosita edhe njëherë të bënin kujdes përgjatë shpërthimit të granatave, meqenëse këto ishin granata mbrojtëse dhe e kishin diametrin e asgjësimit deri në 200 m.

E parandieja se lufta do të ishte shumë e ashpër. Edhe më e ashpër sesa unë e kisha imagjinuar.

Ushtarët ishin të heshtur e përmes asaj heshtjeje unë përpiqesha të hidhja ndonjë humor të kulluar sa për të ndryshuar pak atmosferën.

M'u kujtua diçka dhe lëvizja nëpër togën time, po e bëja edhe një kontroll, për shkak se ushtarët nuk e dinin nëse iu funksiononin armët. Nuk dihej fare, se a funksiononin golinovat (arma më e rëndësishme e luftës këmbësorike), mitralozët e lehtë, pushka snajper?! Nuk e dija as vetë, se sa do të kishin mundësi të rezistonin ata automatikë, pjesa dërmuese e të cilëve ishin prodhim i Shqipërisë. As unë nuk e dija, si epror i

tyre, se sa do të mundnim ne t'a shtynim me municionin që e kishim. Nuk e dija se çfarë do të ndodhte, nëse armët do të bllokoheshin apo prisheshin dhe këto nuk do të mundnin të funksiononin më, pasi nga shtabi nuk na ishte prezentuar dot ndonjë specialist për këto e as ndonjë prapavijë, sado e thjeshtë që ajo do të kishte mundur të ishte.

Pasi përfundova kontrollin me ushtarët e mi, erdhi lajmi se eprorët e togjeve si edhe ata të kompanive të shkonin menjëherë në një mbledhje tek kuzhina.

Edhe pse e dija se pyetjet dhe kërkesat e mia eprorëve të shtabit të atyshëm nuk iu binin për shtat, nuk do të heshtja për problemet e mungesat, të cilat dukshëm viheshin re.

Komandanti i TF-it (batalionit), Fazli Berisha, së bashku me komandant Ramizin, parashtroin rregullat dhe urdhërat e fundit. Të gjithë ishim të mbledhur. Së shpejti do të gjendeshim në luftë, për të cilën ne u përgatitëm aq shumë. Sido-kudo sytë e Fazliut dhe të Ramizit, gjatë pjesës dërmuese të bisedës, drejtoheshin ose tek unë, ose tek Safeti, si eprorë me ushtarë të përgatitur.

Dhe në këtë ditë pra, më 25 maj 1999, e martë, rreth orës 16:30 na dhanë neve - komandantëve të kompanive dhe të togjeve - edhe telefona personale apo "Walkie-Talkie" të markës "Motorola", prodhim gjerman. Këta funksiononin me bateri, e cila shfrytëzohej me ndërprerje në një hark kohor prej 48 orësh, pastaj duhej të mbushej apo të ndërrohej. Secili nga ne kishte shifrën e vet apo parullën personale. Parulla e secilit hapej me fjalën "Vullneti". Kështu komandant Fazliu ishte

"Vullneti 55", Isai "Vullneti 61", Logjistika 69, toga e parë (unë) 62, toga II - 63, toga III - 64 etj.

Të dy komandantët, Fazliu dhe Ramizi, na informuan se me rregullin dhe me seriozitetin më të madh do të furnizoheshim me bukë, me ushqime, me ujë e municion, do t'na mbusheshin telefonat, pa hyrë në detaje se si e qysh do u bëmë ky furnizim.

Ne, sa qemë aty, ju besuam këtyre premtimeve. Ndërsa unë, duke u nisur nga faktet konkrete të mëparshme - të një indiferencizmi ekstrem -, m'u desh, në emër të ushtarëve të mi, të ndërhyja:

„Po nëse nuk furnizohemi me bukë, me ujë e me municion? Nëse armët bllokohen e prishen? Nëse neve na këputet kontakti, ngase telefonit i harxhohet bateria dhe kjo nuk është mbushur sipas marëveshjes? Nëse, ta zëmë si shembull, ushtarët për bartjen e të plagosurve duhet të ecin plot 6 orë rrugë malore e logjistika sipas planit dhe programit nuk funksionon? Çfarë atëhere?”

Pyetjet e mia mbase iu dukën disfatiste, megjithatë ata nuk e shprehën këtë, por sërish prezentonin siguri maksimale për funksionimin e një prapavije në shkallën më të lartë.

Në mbështetje të tyre kërceu edhe Isai, i cili tha:

„Po si mundesh edhe ti bre të dyshosh kështu, bre Arber? Po normal, se do t'funksionojë gjithçka.”

Ky rol i tij - prej avokati - m'i acaroi nervat, ndaj unë edhe iu përvisha:

„E para; ty s'të pyeti kush! E dyta; unë komandoj njerëz nga mishi dhe nga gjaku, të cilët nuk i linda vetë, por për jetën e të cilëve unë përgjigjem. Ushtarët janë të lodhur deri në limit: Janë të pafjetur dhe të pangrënë, përderisa të vetëçuajturit 'komandantë' fjetën në krevate të buta dhe poqën mish e suxhuk të Kosovës dhe e hëngrën bukën e ushtarëve, para syve të ushtarëve të tyre! Nuk udhëheq pra unë patate, por njerëz”, i mëshova edhe më fort zërit.

„Arber, qetësohu të lutem. Kjo është kontratë, betim dhe premtim ushtarak. Çdo gjë do të funksionojë sipas planit dhe programit. Asgjë nuk do të devijojë. Këtë jua premtojmë ne - si burra dhe si eprorë -, të shtabit të këtushëm të UÇK-së!”

Kështu u betuan para të gjithëve, Fazliu dhe Ramizi, për plane dhe programe serioze ushtarake.

Edhe mua më vinte mirë dhe shpresoja se do të funksiononte gjithçka ashtu siç edhe premtuhej. Sepse, mereni me mend, kishte dy muaj që asnjëri nga ne nuk posedonte librezë ushtarake, edhe pse për këtë gjë ne qemë fotografuar në Burrel. Të rrallëve - vetëm një pjese thuajse të papërfillshme, nga numri i përgjithshëm i ushtarëve - ju ishin shpërndarë medaljet për identifikim individual gjatë luftës. Përderisa këta të shtabit donin, që në Burrel (fundi i prillit dhe fillimi i majit 1999) ato të na i kompletinin dhe shpërndanin neve! ... Prandaj, fort më mirë do të kishte qenë, t'ju kishin thënë ushtarëve popullorçe, se kjo dhe kjo bëhej ose nuk bëhej, në mënyrë që secila njësi ushtarake t'a ndërtonte punën mbi gjëra konkrete e jo mbi gjëra abstrakte, se sa të

dëshproheshin e të tradhtoheshin ushtarët me gënjeshtër të paskrupullta. Konkretja ishte pronë e terrenit ku ne po operonim, ndërsa abstraktja ishte duke pushuar diku në një tavolinë. E si për të dashur të na bindnin se tani e tutje çdo gjë do të shkonte si sahat, na shpërndanë për secilën togë nga 16 bukë! Pra, dy ushtarë kishin një bukë, e cila ngjante si një kilogramëshe ... Përndryshe një ushtar kishte vetëm gjysmën e bukës me vete. Kjo ishte pra për stomakun që nuk ishte ushqyer prej dy ditësh; për dje, për sot dhe për nesër ... E vetëm se ishte mbrëmje dhe neve, deri më tani, na dridheshin leqet e këmbëve nga të pangrënë! Kurse ushtari i gjorë - luftëtari i lirisë - o mundte t'a hante atë gjysmë buke përnjëherësh, ose të mendonte edhe për të nesërmen, në mënyrë që t'i ngelnin disa kafshata. E përderisa ne përballeshim me këtë realitet migjenian, nga kuzhina e shtabit vinte era e mishit të pjekur dhe e suxhukëve, madje 'komandantët e shtabit' i kollofitnin këto produkte edhe në sy të ushtarëve të uritur, të cilët edhe në luftë po futeshin me barkun bosh!

Pra, na premtuan se do të na furnizonin me bukë, me ushqime, me municione e çfarëdo gjëje tjetër dhe ja, tani përsëri, ky realitet tronditës. Megjithatë kishim vendosur edhe pak të prisnim dhe të shihnim. Ky ishte shansi i fundit që unë personalisht ju jepja këtyre eprorëve. Ndryshe, nëse na linin në baltë e mendonin veç për jetën e tyre, i meritojnë epitetet, të cilat ne ia kemi dhënë veç shkaut!

Errësira kishte rënë gjithandej. Askund një dritë e vetme nuk dallohej, që të mundeshe të orientoheshe sadopak!

Gjatë gjithë ditës që e përmenda më lartë, mbretëroi kohë e thatë, me Diell dhe e nxehtë. Edhe Zoti nuk na pengonte, përderisa ne ishim shtrirë në natyrë. Çfarë skenash të paharruara! Kurse tani, meqenëse errësira kishte rënë, bënte paksa freskët.

Dikur u dha urdhëri për marshim. U rreshtuam brenda limitit kohor. I kontrollova përfundimisht ushtarët e togës sime: Të gjithë i kishin lopatat, maskat, armët, municionet, bombat e dorës - dhe çdo ushtar më pak se gjysmën e bukës - afër vetes. Pak prej tyre i kishin paguret e mbushura me ujë.

Në gjendjen, në të cilën ne gjendeshim; disa netë qëkur nuk kishim fjetur e disa vakte ushqimi qëkur nuk kishim grënë, dallohej qartë trupi i raskapitur nga lodhja e stërmundimi. E lëre më të marshonim përsëri edhe me rreth 40-50 kilogramë në shpinë. Kuptohet se ky ishte marshimi i fundit dhe ne e bënim, sepse ishte i domosdoshëm. E bënim për popullin Shqiptar, për Kosovën dhe për banorët e saj të vuajtur.

E martë, 25 maj 1999. Ora ishte 22:00. Po marshonim në njëshkolonë. Togë pas toge, skuadër pas skuadre, ushtar

mbas ushtari po i afroheshim vijës së frontit. Po marshonim për në luftë. Me automatikun në dorë, me karikatorët rezervë të mushur me municion, me çantën në supe, po i prija togës sime. Këtyre ushtarëve, të cilët më trimëronin, m'ja jepnin titullin epror dhe pa të cilët unë do të dukeshja një hiç!

Të gjithë e mernin seriozisht aktin që kishim përpara. Se për këtë u përgatitëm për kaç kohë. Dhe kjo më pëlqente tek ushtarët e mi. Të gjithëve thuajse na vlonte gjaku dhe thuajse na kishte ikur lodhja për disa momente. Secili në heshije, me mendjen e vet, thurte kujtimet e kësaj jete që e ka emrin sakrificë -, sakrificë për hir të një ideali -, sakrificë për të nesërmen e Kosovës, për lirinë dhe pavarësinë e saj!

Ishte mesnatë. Përgjatë një kodre gjysëm të ngritur të asaj bjeshke ishim renditur sipas sistemit rreshtor. Tanimë ne ishim përfundimisht pa eprorët e ashtučuajtur "të lartë", pasi ata mbetën pas nesh, në territorin e Shqipërisë! Ndoshta ishte më mirë kështu! Ah, sikur këta ushtarë do të kishin pasur udhëheqës të pastër e jo të krimbur! Atëhere (edhe pse kjo luftë do të jetë luftë e ashpër), me siguri se unë, do të marshoja me këta trima, nga aty e deri në Podujevë! Vendosmëria e ushtarëve, për t'i shkuar çështjes deri në fund, më bënte edhe më optimist, siç ia thonë një fjalie; 'më bënte me krahë', më bënte edhe shumë më të afërt me secilin!

O Zot, sikur çdo gjë do të funksiononte siç duhej dhe shtabi do të mbante fjalën dhe të realizonte premtimet dhe obligimet ushtarake, sikur edhe eprorët të arrinin t'i fitonin

zemrat e ushtarëve, atëherë edhe fitorja do të ishte shumë më pranë.

Menjëherë mbrapa kësaj kodre gjindej Kosova! Tani e tutje do të lëvizim sipas organizimit ushtarak, me urdhër dhe me disiplinë. Nuk do të kishim më mundësinë të lëvizim të lirë, meqenëse do të gjendeshim në luftë e edhe terreni me siguri se do të jetë i minuar. Ne ishim njësitë i parë, gjatë kohës së Luftës në Kosovë, i cili do të arrinte t'a shpërthente këtë kufi; këtë kufi, të cilin deri më sot nuk kishte arritur t'a shpërthente asnjë njësit tjetër i UÇK-së. Ishte kufi famëkeq. Ne nuk kishim as ndonjë trupë speciale ushtarake, e cila do të merej me ç'minimet. Ne -, po, po, vetë ne - do të duhej, që edhe terrenin ta pastronim nga minat, në mënyrë që të mundnim të përparonim. Ky ishte thjeshtë, deri më tani, pyll i pashkelur gjatë luftimeve. Ky ishte shkelur vetëm nga armiku, i cili e kishte mbjellur me mina çdo shteg kalimi dhe i cili, nga aty e shumta 120-200 metra larg në vijë ajrore, ishte stacionuar dhe po na priste. Ishte ky Pashtriku (drejtimi i Prizrenit), kurse ne ishim Brigada 128-Pashtriku. Kjo brigadë përbëhej nga shqiptarët, të cilët edhe pse po luftonin, nuk harronin të bënin diferencime regjionale! Psh.: Isai nga Kumanova e Nuhiu (nëse nuk gabohem) nga Gjilani apo Ferizaj, ishin gjithnjë afër njëri-tjetrit. Dhe Isai e harronte edhe funksionin e vet si epor kompanie. Aq sa, bash për këtë, ai nuk e meritonte pozitën, e

cila i ishte dhënë. Ahmeti ishte me prejardhje nga Podujeva, kështu që Arsimi, vëllai i "Bugarit" si edhe "Fexhi" ishin afër këtij. Mirëpo Ahmeti, sido-kudo ishte njeri i zgjuar dhe e kuptonte nocionin ushtri. Ky ishte tërë kohën me togën e vet, afër meje dhe ushtarëve të mi. Atëhere Fazliu vinte nga Podujeva dhe rrinte më tepër me Safetin - pranë togës së këtij -, i cili vinte nga Mitrovica! Avniu ishte pak më i diferencuar, rrinte vetëm dhe vetëm me ushtarët e vet! Ndërsa unë ... unë - në togën time -, në dallim nga të gjithë, kisha ushtarë që vinin nga të gjitha trevat e banuara me shqiptarë. Pra, në kushte lufte, nuk bëhen diferencime krahinore, sepse këto kanë pasoja të rënda dhe eprori, duke e trajtuar njërin ushtar si të nënës e tjetrin si të njerksës, e humb rolin dhe misionin e vet ushtarak dhe nuk i kryen detyrat siç duhet. Dukuri të këtilla të jepnin direkt të kuptoje se shumica nuk e meritonin të ishin aty ku gjendeshin sot dhe, se në mënyrë të pamërituar një pjesë e eporëve ishin zgjedhur duke e tërhequr njëri-tjetrin.

Kështu edhe ne, përgjatë kodrës kufitare, duke filluar nga e majta e krahut tim, ishim rreshtuar me sa vijon: Isai, mbas të cilit në rresht për një vinte Nuhiu me togën e tij, pastaj Avniu me ushtarët e vet, mbas tij, po ashtu në rresht, unë me togën time. Mbas meje renditej Ahmeti, më pas Ekremi (jo ai Ekremi nga Prishtina) dhe Safeti me togat e tyre. E aty do t'vendosej edhe Fazliu. Po Fazliu, si komandant i TF-it, a nuk e kishte vallë vendin edhe më afër nesh? Pra ... po shihej!

Nga e djathta, përgjatë kësaj kodre, dalloheshin vetëm disa ushtarë, meqenëse - nën dritën e Hënës - artileria po

kompletohej dhe ishte duke i zënë vendet e veta. Këta ushtarë do të jenë shumë të rëndësishëm për ne! Dhe vërtetë po shpresoja që këta të ishin të kualifikuar dhe të dinin të kryenin misionin dhe detyrën e tyre e në asnjë çast gjatë luftës të mos më granatonin ushtarët e mi.

Ja hodha një sy shtatit të artilerisë e sikur nuk më bindi! „Qofsha i gabuar në dyshimin tim!”, po mendoja vetëm për veten time në ato çaste.

Telefonin e kisha të hapur dhe komandant Fazliu po na testonte secilin, a ishim në kontakt apo jo edhe se a funksiononte parulla-shifra individuale. Telefoni funksiononte për mrekulli, secili dëgjohej mirë dhe qartë. Vetëm një gjë shpresoja: Që armiku të mos arrinte të zbulonte valët tona, pasi ashtu edhe do t'i gjente më lehtë pozicionet se ku ne ndodheshim. Mos o Zot që në mesin tonë të kishte depërtuar ndonjë agjent i serbëve e të priste ditën e sulmit për të na dekonspiruar!

Gjithsesi, në këtë organizim para lufte, ndihej se trupit tonë i mungonte koka; nuk erdhi dikush i ngarkuar nga shtabi kryesor, i cili do të kishte ngritur moralin e ushtarëve dhe do të kishte zgjuar ndërgjegjen atdhetare, e cila i kishte urdhëruar të ishin aty, përballë serbit, aty ku jetën, nga vdekja, vetëm një qime floku mundte t'a ndante. Në fund të fundit; t'ju kujtonte këtyre - djemve e vajzave - luftëtarëve të lirisë se ne nuk ishim robotë, por njerëz!

Ishte koha të ripërtërinim pak energjitë e mbetura e të bënim një sy gjumë. Telefonin e kisha lënë të hapur dhe po

prisja komandën e fundit për të shpërthyer kufirin. Me veshin afër telefonit, më kishte rrëmbyer gjumi ...

26 maj 1999, e mërkurë.

Nata u thye dhe një fashë drite që lajmëtarja e një dite të re, e cila po agonte! Nuk e besoja që të kishte fjetur e gjithë toga bashkë me mua për disa orë rresht, krejt afër serbëve. Të cilët, sikur t'a dinin se ne po flinim, do të kishin bërë atë hap luftarak, saqë ne do të ishim ndier gjithë jetën të turpëruar. Por, për fat, shkau jo vetëm se kishte qëndruar në pritje, por kishte ndërprerë edhe granatimet.

Mbase sikurse toga jonë, kishin vepruar edhe togjet e tjera. E tani unë kisha mundësi që ato t'i shihja, përgjatë kodrës ku gjarpëronte renditja e ushtarëve të UÇK-së. Duke filluar që nga ushtarët e togës sime e deri tek ata të togjeve, të cilat m'i kapte shikimi i lirë, dalloja se shumica prej tyre po flinin akoma. Vura dylbitë të vërtetoja se mbase kjo gjëndje ishte prezente edhe përtej. Dhe nuk doja t'a besoja se edhe Isai, edhe Ahmeti po flinin akoma! Fazliun nuk po e dalloja njëherë.

Zgjova pa bërë shumë zhurmë dy-tre ushtarë të mi, të cilët ende po koteshin dhe i orientova të mernin pozicionin luftarak.

Kupa e Qiellit vinte e mbushej me dritë dhe tani, përmes dylbive, shumë qartë, nga këtu mundja të vrojtoja edhe artilerinë tonë. Më ngjante se kjo ishte sistemuar përfundimisht dhe së shpejti do të fillonin granatimet. Ata posedonin ca

minahedhëse dhe topa shumë të vjetër -, nëse nuk gabohem -, që nga Lufta e Dytë Botërore. Larg qoftë, që tytat e tyre neve, ushtarëve të UÇK-së, të na ngatërronin me serbët!!!

Mora telefonin dhe po i zgjoja me radhë komandantët e togjeve, të cilët ende po flinin dhe të cilët unë i kisha disa dhjetra metra larg, sepse aty ne ishim rreshtuar simbas distancës (ushtari me ushtarin) në luftë, pra batalioni në sulm.

„Vullneti 64, Vullneti 64, këtu Vullneti 62, zgjohu dhe zgjoji ushtarët. Zgjohu, Avni! Dhe lajmëroje Vullnetin 61 të zgjohet dhe të shohë se akoma i ka ushtarët në gjumë. Kuptove?”

„Kuptova, Vullneti 62, të falemnderit! E sheh Arber se ku është ngjitur Isai? A e ka ai vendin atje, si komandant kompanie?”, m'u përgjigj e më pyeti sakaq Avniu, ndërsa po e zgjonte edhe Isain.

„Vullneti 61, këtu Vullneti 64. Zgjohu dhe zgjoje Vullnetin 63 si edhe ushtarët e tij”, lajmëroi Avniu Isain dhe kuptohet se unë përmes telefonit tim mundja t'i dëgjoja ndërkohë edhe bisedat e eprorëve të tjerë.

„Të kuptova Vullneti 64, zgjohu Nuhi, zgjohu!”, u dëgjua zëri i Isait.

Ahmeti vetëm se ishte zgjuar.

Ndërkohë ndjeva një si lëmsh zjarri në krahëror. Më kishte pushtuar një e kollitur, të cilën mezi e sundoja, që të mos dëgjohesha nga larg. U kollita thellë dhe vazhdimisht. Dhe tinës ushtarëve - pasi që ushtarin tim më të afërt e kisha 5-6 metra larg -, pështyva gjak. Kollë dhe prapë gjak. Duke fjetur

jashtë, të djersitur e të lodhur, me sa dukej, e ftohura e kahershme po më thoshte se “ja mbërrita”.

„Zotëri komandant, Arber, gjithçka në rregull?”, më pyeti Bujari që e kisha më afër.

„Bujar, jam ftohur pak, me sa po e shoh, por do të më kalojë!”, ia ktheva unë duke ia fshehur brengosjen që më kishte kapluar.

Mbrapa rreshtimit tonë, atje poshtë, në largësi rreth 50 metrash, dalloja Fazliun dhe komandantin “Daja i vogël”. Krejt afër tyre ishin mbledhur disa banorë të atyshëm, nga Hasi i Shqipërisë. Tani, me dylbi po i dalloja edhe më mirë. Dy veta ishin me uniformë policie! Njëri prej tyre iu drejtua eprorëve tanë, por me zë të ngritur, saqë shpati e solli domëthënien e tij deri tek unë:

„Çfarë po bëni këtu, more, doni të na fusni akoma më thellë në sherr me jugosllavët?”

Të them të drejtën kjo pyetje më tronditi, aq sa nuk doja t'a besoja se ai, i cili e bëri këtë pyetje, duhej të ishte shqiptar.

Meqenëse ose Fazliu ose “Daja i vogël” e kishin lënë telefonin hapur, tani arrija t'a dëgjoja bisedën me ton edhe më të ulur:

„Ne po e shpërthejmë kufirin këtu dhe do të luftojmë!”, iu përgjigj të panjohurit “Daja i vogël”.

„Si ore, me këta topa e me këto armë? Me ushtarët e pajetur e të pangrënë? Ju kemi parë edhe mbrëmë kur mbërritët, po i shohim ushtarët edhe sot; në vend se të na përshëndesnin me ‘mirë mëngjesi’, këta na kërkuan bukë. A

s'ju dhimbsen juve këta bijë nënash?", ndërhyri prapë banori i atyshëm dhe unë e mora përgjigjen e mëdyshjes sime.

„Ne jemi të armatosur si s'ka më mirë dhe po hyjmë në luftë e ju largohuni prej këndej”, këmbënguli komandant Fazliu.

„O zotërinj, unë shpreh vullnetin e banorëve të këtushëm, sepse, ngase ju do të luftoni kundër tyre, ata do të bombardojnë jo vetëm pozicionet tuaja, por edhe shtëpitë tona e ç'tju teket! Do t'a granatojnë ndoshta edhe Krumën. Do t'i vrasin njerëzit në gjumë ... A e dini ju se çfarë potenciali luftarak kanë ngrumbulluar serbët përballë neve, në këto ditët e fundit?! Ne menduam vetëm t'ju themi juve, se këta ushtarë janë bijtë e Shqipërisë e për hiçmosgjë s'po kemi qejf t'ja japim serbit si viktima!”, iu përgjigj eprorëve tanë vendaliu duke ngritur supet lartë nga dëshpërimi. „Këta djem po më duken të sfilitur, edhe pa hyrë në luftë!? Ç'po bëni kështu, vëllezër?!”, dëgjoja unë përmes telefonit dhe çdo fjalë e tyre më dukej se shndërrohej në granatim për disa shefa të shtabit, të cilët lejuan që ne t'i afrohem frontit pa një kondicion të plotë fizik e shpirtëror të ushtarëve.

Kur vendasit e panë se po flisnin me të shurdhët, ikën duke tundur kokat.

Ndërkohë telefonat gjëmuan:

„Këtu Vullneti 55, këtu Vullneti 55. Komandantët e kompanive dhe të togjeve të bëjnë ushtarët gati për të marshuar përpara”, njoha zërin e Fazliut.

„I thuaj se 'Daja i vogël' po t'a çon 'amanetin' në vend! Sot po e shpërthejmë Pashtrikun! Kjo është datë historike për UÇK-në dhe për ne!”

Nga telefoni im po dëgjoja bisedën e “Dajës së vogël”, përdërisa ky po i drejtohej dikujt tjetër (!) e mesazhi destinohej logjikisht për zotëri Hashim Thaqin!

Ora kishte shkuar gjashtë. Të gjithë ushtarët ishin në pozicion luftimi. Pritej urdhëri. Artileria jonë ndërkohë e mori urdhërin dhe po i binte “daulleve” të saja! Gjëmimet e predhave bënin që adrenalina të lëvizte vullshëm nëpër venat e trupave tanë. Një gjë e tillë të mbushte me guxim! Ndërkohë edhe ne morëm urdhërin të marshonim. Paçim fat dhe Zoti qoftë me Kosovën e me ne!

Shpejt arritëm të kapnim kuotën më të lartë të kodrës. Prej këndej me dylbi vëreja trupat armike se si po e vrojtonin terrenin dhe si po i mernin pozicionet e duhura. Ruheshin nga predhat që vinin nga ne.

Duke studiuar terrenin, dallova një banesë. Në vijë ajrore nuk ishte as, e shumta 100-120 metra larg prej këndej, ndërsa distanca, në vijë tokësore, e shumta 1500-2000 metra. Mirëpo për t'a përshkuar i sigurt këtë rrugë, duke e marë parasysh se ishte bjeshkë -, pra mal dhe çdo shteg ishte i minuar nga serbët -, duheshin minimum 16 orë, pra deri në të errur të kësaj dite.

Nga maja e kodrës vëreja se granatohej në afërsi të asaj banese fshatare, e cila gjendej në luginë. Ashtu, si brigadë, siç ishim të renditur, ne edhe po marshonim.

Duke u lëshuar poshtë asaj kodre, nga ana e Kosovës, gjarpëronte një vijë e thellë, por e cila ujë nuk kishte! I ngjante më tepër një gremine. Kjo edhe na ndante njëherësh si kompani ... Isai me Nuhiun ndodheshin nga e majta e saj, po ashtu edhe Avniu me ushtarët e tij. Këta ecnin ashtu siç edhe ishin më parë, ngadalë, me zvarritje, njëri pas tjetrit, në distancë diku më të madhe e diku më të vogël. Kishin vendosur të krihnin terrenin, duke lëvizur me kujdes, pasi shtigjet e kalimit mundnin të ishin të minuara.

Unë vendosa tjetër variant. Së pari dërgova vëzhguesit përpara. Sepse më mirë (shpresoja t'i ruante Zoti, në radhë të parë) ishte t'i rrezikoj dy ushtarët-vëzhgues, se sa të rrezikoj më shumë ushtarë e besa edhe të gjithë togën ...

Vëzhguesit, sipas komandës, lëviznin ngadalë, ndërsa ushtarët e tjerë pas tyre në distancë, rreptësisht njëri pas tjetrit. Këta lëviznin përpara jo pa kontroll, por vetëm përgjatë kalimit të sigurt që e hapnin vëzhguesit. Dhe në distancën e caktuar membin pozicion gatishmërie, strehoheshin dhe ishin të gatshëm të mbroheshin. Edhe Ahmeti e ndiqte këtë përvojë dhe e aplikonte për ushtarët e vet.

Nuk ishte e lehtë të ishe burrë në këso rastesh.

Nga këtu i vrojtoja bjeshkët e Kosovës, terreni i së cilës aktualisht më ngjante ende si një burg. Me sytë e mendjes shihja vajzat shqiptare të dhunuara nga shkijet e nga

shërbëtorët e tyre, kushdo të kishin qenë ata, edhe shqiptarë të shitur. Shihja njerëz të sakatosur e të masakruar, gra e fëmijë. Shihja varreza masive, si pasojë e një shovinizmi të egër e të pashembullt. Shihja se si prindi shqiptar, detyrimisht, duhej t'a pinte lëngun e asaj kusije, ku shkijet ia kishin zier fëmijën! Kjo ishte Kosova martire, e vuajtur, e përgjakur ... Ne ishim bijtë dhe viktimat e saj! E populli i pashkolluar dhe i keqpërdorur vuante, ngase nuk e gjente shtegun për të ecur më tej! Meqenëse nuk e lanë Sinan Hasanat, Ali Shukritë, Fadil Hoxhët e Azem Vllasët, etj., si udhëheqës, të cilët -, kush më shumë e kush më pak - i kanë borxh këtij populli. E sot ne po e paguanim çmimin. Populli dje i zgjodhi këta udhëheqës, sepse besoi se këta do t'a mbronin, i priste në shtëpitë e tij, aq mirë, sa thujse pati zbritur mbreti Agron në tokë! Ua hiqnin fëmijëve kafshatën nga goja dhe mbushnin tavolinat 'e mirë se ardhjes'. Për lexuesin e nderuar, unë po e sjell një shembull, si dëshmi për këtë:

Atëbotë, në Dobrigje, Gjakovë e rrethina, vinte Sali Syla (dhëndri i babait tim) në vizitë te bukëdhënësit e pashkolluar. Edhe fëmijët dilnin nëpër rrugë, ashtu të leckosur siç ishin, e prisnin me lule në duar "pseudoluftëtarin" Sali të ditëve të errëta të botës serboçetnike gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Kështu edhe ky Sali Syla, me filloren e kryer me intervenime, vinte në fshat dhe fshatarët e shkretë ia prisnin edhe pulën vojce, në mënyrë që t'ia kompletonte sofrën! Dhe fëmijët, kushërinjtë e mi, atëbotë fort të vegjël, shihnin përmes vrimës së derës me barkun e zbratur!!! Saliu i frikësonte këta

me dhunën e shtetit serb ... kurse bukëdhënësit e pashkollë, e dëgjonin këtë farë intriganti të maskuar me profetësi, përderisa etiketonte me çfarë nuk e meritonte babain tim, Ciceronin, si edhe Ali Metën, një burrë fort të ngritur dhe të njohur nëpër ato rrethina! Sepse këta me diturinë e tyre ia zinin rrugën ... mu ashtu siç ia zinin rrugën shtetit serb akademikët shqiptarë të Kosovës (për fat të keq aso kohe ishin të paktë në numër, por jo të paktë në vlera). Kështu ky Saliu e keqpërdorte bujarinë e njerëzve të thjeshtë. Ky mundte të depërtonte te babai im vetëm përmes vëllezërve të tij analfabetë, të cilët s'kishte as babai im e as Ali Meta se ku t'i çonin!!!

Meditimin tim e shkërmoqi një granatim, i cili më solli sërisht mes ushtarëve të mi, të cilët ende nuk kishin marë urdhër për të hapur zjarr. Edhe pse ishin të drobitur, në këtë moment sublim, nuk e jepnin veten. Duhej të prezentoreshin si ushtri profesionale, t'a kursenin municionin, t'a ruanin veten dhe shokun e të mos kishin mëshirë për armikun. Të ishim syçelë e të shihnim se ku po shkelnim, madje tepër të kujdesshëm edhe kur e vinim këmbën mbi fletëzat e pemëve në tokë.

Për një çast po e vëreja terrenin atje poshtë. Granatimet nga artileria e jonë vazhdonin, herëpashere hidhej nga një predhë sa për të thënë se ne ishim aty! Trupat serbe mundoheshin të maskonin artilerinë e rëndë, sepse, me sa

dukej NATO-ja i fotografonte përmes satelitëve, ndaj edhe aeroplanët e NATO-s fluturonin mbi kokat tona në lartësi aq të madhe, sa që mezi dëgjoheshin. Vetëm kur lëshonin predha dhe raketa në afërsi të pozicioneve të armikut, e ndienim forcën e tyre nga krisma e fuqishme dhe tymi i dendur që ngrihej përpjetë. Këtë teatër luftimesh e shihnim qartë. Madje arrinim të kuptonim se nga këto bombardime serbët duhej t'a kishin pësuar keq, pasi shiheshin lëvizje përtej dhe bindeshe se armiku me siguri kërkonte përforcime të reja dhe këto vendime dhe lëvizje trupash bëheshin nga strategë ushtrie të shkolluar nëpër akademi të njohura. Kishin përvojë ushtrie e lufte, ndërsa armët e kishin nga më të sofistikuarat. Ushtarët serbë ishin të veshur e të mbathur. Ndoshta një pjesë e mirë e tyre, para se të mbërrinin ne, edhe kishin fjetur deri më tani në ndonjë hotel të Brezovicës, apo vinin drejt e nga Prizreni (që gjendej akoma mbrapa këtyre bjeshkëve), ishin të ngrënë e të pirë, sipas standarteve të çdo ushtrie. Pra, s'krahosoheshin forcat tona me ato të kundërshtarit. Përballë tyre ne e kishim vetëm një avantazh jo të vogël: Mbronim vatrat tona, kërkonim lirinë dhe pavarësinë e kjo na bënte të besonim se do të triumfonim në këtë luftë!

Ndërkohë vëreja diçka që s'po më pëlqente: Forma e të marshuarit. Dalloja Isain, i cili ishte afër Nuhiut dhe ushtarëve të tij, se si marshonin përpara, pa kontroll. Edhe Avniu i ndiqte mbrapa, thuajse ishin duke bërë gara atletike! ... Po këta të mjerë edhe luftën nuk e mernin seriozisht! Trembeshja kur mendoja se ushtarëve me këso veprimesh amatoreske do t'ju

dilte gjumi kur të binte viktima e parë! Të shkretët ushtarë se nga kush po udhëhiqeshin!

Shkijet reagonin mu ashtu si i duhej një ushtrie. Ishin të qetë, nuk lejonin asnjë anarki dhe, siç dukej, sulmi i artilerisë sonë nuk iu kishte shkaktuar asnjë plagë. Megjithatë ata po përforcoheshin, po pozicionoheshin dhe po prisnin. Nuk iu kundërviheshin sulmeve tona, siç dukej ata po na testonin forcën.

Por erdhi një çast, kur -, përderisa shkijet po e lëviznin artilerinë e rëndë - pilotët e Aleancës i pikasën dhe zunë të hidhnin raketa mbi ta. Bjeshka u ndez flakë! Fluturakët e NATO-s ishin koncentruar mbi hapësirën tonë. Gjëmimet, të cilat i përcillnin bjeshkët, na mbushnin me besim në fitoren e afërt, se kur e ke një aleat të tillë si NATO-ja, atëherë kupton se e ke botën e përparuar në krah. Ndaj në atë çast se si më dolën këto fjalë nga goja: „May God bless you America and you Great Britain” (Zoti të bekoftë ty, Amerikë, si edhe ty, Britani e Madhe!).

Pasi vëzhguesit më siguruan për terrenin, urdhërova të lëviznin më tutje ushtarët. Kështu, hap pas hapi, ne po i afroheshim pozicioneve të armikut.

Granatimet nga ana e jonë vazhdonin më tutje, ndërsa armiku, si mbrëmë, ashtu edhe sot, nuk reagonte. Kjo kuptohej se granatimet tona deri më tani ishin të parrezikshme, ndryshe pse të heshtte serbi aq gjatë e të rrinte “sus” nën predhat tona? Ato mezi i afroheshin fshatit. Më shumë ky granatim i ngjante një demonstrimi se sa një luftë të vërtetë. O Zot, mos

veprohej kështu që nesër, ata, të cilët e komandonin artilerinë, të mburrkëshin duke thënë “se e paskëshin bërë namin”!

Duke kontrolluar çdo pëllëmbë tokë nga minat që janë për ushtarin aq të rrezikshme, nuk nguteshim të përparonim. Kontrollonim çdo dru, lis a shkurre, duke parë më kujdes, me armën në gjendje gatishmërie, se mos armiku na godiste befasisht.

Kështu arritëm në pyll dhe po lëviznim me kujdes. Prej këndej nuk shihej më kodra, prej së cilës ne marshuam. Kjo me siguri se tani duhej të ishte fort lart. Ne, pra, po zbrisnim poshtë bjeshkës. Para nesh u shfaq një fshat , në të cilin edhe armiku ishte i stacionuar. Ai e njihte terrenin, kurse ne jo. Armiku e dinte se ku i kishte vendosur minat, kurse ne jo!

Përrreth i kisha vetëm ushtarët e mi, të cilët, sipas komandës ishin në distancën e caktuar njëri nga tjetri, sepse armiku mundte në çdo moment të na granatonte. Ushtarët ishin të maskuar dhe lëviznin me kujdes. Deri në mundësinë e vërtetë, i dërgoja dy vëzhguesit përpara. Pasi këta më jepnin sinjal, unë ju jepja ushtarëve urdhër të lëviznin më tutje. Çdo gjë me hapa dhe veprime të sigurta.

Sipas marrëveshjes me ta, sinjalet ju jepja ushtarëve me shenja e jo me zë, në mënyrë që të mos dëgjoheshim.

Të gjithë ushtarët ishin fort të motivuar dhe plotësisht në gjendje lufte. Qetësinë e veprimit e prishte vetëm telefoni im, të cilin unë e kisha të hapur; kur kohë pas kohe kontaktonin o Isai, o Fazliu, o Safeti. Unë akoma personalisht nuk isha lajmëruar!

Megjithatë secili e dinte detyrën e vet, misionin dhe arsyen e s'kishte përse të lajmërohej. Kështu unë akoma nuk kisha arsye. Ndërsa vetëm më lejoni t'ju interpretoj disa fragmente nga raportet e ndryshme që më kishin arritur deri më tani përmes telefonit:

„Vullneti 55, këtu Vullneti 61”, dëgjonte Vullneti 55 i çuditur.

„Po, pra, s'ka fjalë Vullneti 55”, ia kthente Vullneti 61, përmes një të folmeje të rrokjezuar, thujse nga alkooli i tepërt.

„Shpresoj se nuk kam nevojë t'ju rikujtoj se për çfarë jemi këtu, Vullneti 61 ...”, ia kthente Vullneti 55 dhe i jepte të kuptonte se ne nuk ishim aty duke vjelur molla, por se ju kishim afruar sa s'ka strofullës së armikut! Pra, ishim në luftë, në luftë! Aty qëllon me armë nëse e sheh të nevojshme ... Vret para se të vritesh ...

Ndërkohë toga e Nuhiut veçse kishte qëlluar përmjeherësh. Qenë dëgjuar edhe krismat e golinovit. Nuk e dija se çfarë po bëhej dhe cilin objektiv vallë e kishin vënë në shënjestër, por armiku, me sa po e shihja me dylbi, s'po vepronte ende ... e që të gjithë ne duhej që, së pari, të arrinim tek banimi atje poshtë dhe atëhere të luftonim ... Të mundoheshim t'a kapnim atë pikë e ndoshta edhe të vazhdonim më tutje! E nga ai banim, asnjë fjollë tymi akoma nuk kishte dalë nga tytat. Armiku vetëm po priste. Nuk shihej nga këtu se çfarë bëhej në atë kodër (sipër greminës), atje ku gjendeshin Isai me Nuhiun dhe, me siguri edhe Avniu me ushtarët e tyre. Armët për 3-4 minuta

shkrepën dhe nuk e dija, vërtetë se kundër kujt kolegët e mi po luftonin.

Dikur zjarri pushoi ... Pra, armiku tani e dinte se ku ishim, se ç'pozicione ne zotëronim e kjo në luftë e ka koston e vet. Siç dukej, armiku po përgatitej siç duhej!

Në këtë situatë të tensionuar pasonin telefonatat. Vullneti 61 pyeste Vullnetin 55, nëse i kishin pëlqyer krismat?! Pastaj i thotë se pesë shkije qenkëshin vrarë brenda 3-4 minutash. Ah, sikur kjo do të kishte qenë e vërtetë!

Më ngjante ashtu, thujse të kishim qenë në një garë atletike. Këto veprime e trokime në front, më ngjanin si lodra kalamajsh. Nuk mundja dot të dëgjoja më mburravecë të tillë, edhe për faktin se - me dëftimin e pozicionit, nga u qëllua -, sikur i thoshin serbit: „Hë, pra, qëlloni, tani e dini se ku jemi!”.

Me dëshirë do e kisha fikur fare atë telefon, por nuk mundja, sepse telefoni më duhej ndoshta për ndonjë lajm tjetër të rëndësishëm. Tani befasia e jonë në sulm kishte marë fund dhe armiku do të shfrytëzonte edhe avantazhet territoriale dhe ushtarake që kishte, sepse ai tanimë e kishte kuptuar se sa ishte ora ... o Isa zeshkani!

Ushtarët e mi akoma nuk kishin urdhër e as nevojë të hapnin zjarr. Vazhdonin të blinin e të mos shisnin! Me kujdes, të sigurt dhe sistematikisht! Vullnetëve ju jepja ndonjë lajm të shkurtër, sepse nganjëherë edhe më telefononin. Po

përparonim më tutje, me shpresë t'i jepja armikut një goditje nga nuk e priste, sidomos duke arritur në çminimin e një shtegu, për të cilin armiku e kishte mendjen e fjetur se s'mundte të kalonte dot këmbë e gjallë njeriu pa gjëmuar bjeshka cep më cep.

Përgjatë lëvizjes nëpër këtë pyll, herëpashere hasnim nëpër afishe, të cilat NATO-ja i kishte hedhur nga aeroplanët e saj nëpër Kosovë, nëpër zonat e luftimeve. Ishin këto fletushka të shkruara në jugosllavishte-cirilike, e cila përkthehej si vijon: „Mos më prit mua, deri sa të vij!”.

Kishte shkuar ora dy pasdreke. Ne duke marshuar, veçse kishim avancuar ngadalë, në heshtje.

Deri këtu gjithçka kishte kaluar tej parashikimit, kur të mendojmë se ne gjysmën e rrugës veçse e kishim kaluar ... E kam fjalën - gjysmën e rrugës - për deri tek pozicionet e para të armikut. Ishte pozitive për neve, që ne po zbrisnim teposhtë kësaj bjeshke të pafund e nuk po ngjiteshim përpjetë, pasi ishte shumë, shumë vapë dhe një Diell, i cili të përvëlonte. Kështu që ushtarët, edhe nga stresi i momentit, edhe nga peshja që mbanin mbi shpinë, ishin të djersitur qull në djersë, pra duke humbur shpejt lëngjet e trupit, kur ne as ujë me vete më nuk kishim! Ushtarët me siguri se e kishin ngrënë tanimë edhe kafshatën e fundit të bukës që e patën me vete ... Ashtu sikurse edhe unë ...

Akoma pa nisur lufta, shfaqej një nga defektet më serioze: Nuk funksiononte organizimi e as prapavija. S'kisha ende asnjë informacion, se po na furnizonin me bukë e sidomos me

ujë. Vetëm më kujtoheshin premtimet e Fazliut dhe të Ramizit, përderisa ata dy dje po na i shpërndanin telefonat. Ushtarëve iu duhej pajtjetër, sidomos uji ...

Vëzhguesit e mi më informuan për një rrugicë të ngushtë, të cilën e kishin përpara. Iu afrova dhe po e vëzhgoja terrenin. Ishte një rrugë e ngushtë në trup të kësaj bjeshke. Dukej se e kishin hapur barinjët e atyshëm, për të kaluar me bagëtitë e veta. Aty afër ishte një gropë, për afërsisht 3 me 5 metra, e mbushur me ujë, në të cilën sigurisht se kishin pirë ujë gjëja e gjallë. Uji në atë gropë qëndronte i palëvizshëm, si uji i kënetës, përderisa nuk rridhte. Pra, ishte një lerë, e cila e mbliidhte ujin e shirave, krejtësisht në ngjyrën e dheut. M'u desh për një moment të hapja krahët sa pata mundur, që t'i ndaloja ushtarët e mi, të mos sulleshin për të shuar etjen, pasi ne ishim në luftë dhe mendova se uji mundte të ishte edhe i helmuar. Me vete kishim ca tableta, të cilat ishin të destinuara për dezinfektim. Shpirt është ky! U afruam me kujdes dhe po i mbushnim paguret tona. Vetëm pakëz dallonte ngjyra e këtij uji nga ajo e plehut të kafshëve dhe e baltës! Mora një çorape të larë, të cilën e kisha në çantë, e vura në grykë të pagures dhe ashtu e mbusha duke e filtruar! Mandej ia hidhnim tabletën. E pasi ajo tretej, e pinim ujin me gllënka, edhe pse ujit i vinte era urinë kafshësh ... Ah, jetë, o jetë!

Mbasi të gjithë ushtarët e shuan etjen pa ndonjë komplikacion të dukshëm dhe mbushëm secili paguret, dëgjuam pas krahëve hapa të shumtë që po afroreshin. Nga pjesa e sipërme e bjeshkës ku gjendeshim ne (në drejtim me

Shqipërinë), të cilën unë me togën time e kishim lënë mbrapa, dëgjohej se disa forca po vinin në drejtimin tonë. O Zot, nga mënyra se si na afroreshin, të krijohesh bindja se ata ende nuk e dinin se në ç'zonë të rrezikshme për jetën e tyre ishin! Se kalimi i pakontrolluar nga një pozicion në tjetrin, mundte t'i çonte ushtarët të shkelnin mbi mina dhe pastaj dikush t'a deformonte realitetin duke raportuar në komandë se "ikisi kishte rënë heroikisht në përlëshje me armikun". Në atë situatë, kur nuk i shihja nëse ata ishin ushtarë të UÇK-së apo të serbit, ju dhashë urdhër ushtarëve të mi të mënin menjëherë pozicionin e parë për mbrojtje dhe hapje zjarri. Dhe nuk e di - është enigmatike - se si nuk hapëm zjarr, pasi ne ishim në pyll, aty ku drunjtë dhe shkurret ishin të dendura dhe kush të identifikonte në çast se ishte ushtar i UÇK-së apo serb!

Duke pasë parasysh se eprorët nuk kishin grada ushtarake në krahëror, kështu edhe sa i përkiste informimit në radhët tona, nuk dallonte ushtari nga eprori. E sa më shumë afroreshin hapat, aq më shumë mua më rrihte zemra, deri sa kjo shkoj në rrahjet normale kur e kuptova se më ishte bashkangjitur Ahmeti me togën e tij.

„Qetësohuni, ulni armët!”, m'u desh t'i urdhëroja ushtarët, në mënyrë që të mos gabonte ndonjëri e të qëllonte.

Bashkë me Ahmetin dhe ushtarët e tij ishin Arsimi, "Fexhi" dhe vëllai i "Bugarit". Pra, llapjanët ... Nuk ju besuan syve, se çfarë uji i ndotur i priste për t'a pirë. Edhe ata si ne ishin aq të etur, ndaj u sulën të gjithë drejt ujit. Ca edhe freskoheshin. Ahmeti dhe ushtarët e tij shprehën dëshirën të qëndronin me

togën tonë, duke vepruar si kompani. Në këto kushte të reja, më kërkuan që të isha unë komandant i kësaj kompanie të re. Tani bëheshim 78 ushtarë. Rritja e bëftë e numrit të efektivit, më kërkonte të bëja një planëzim të ri të veprimeve. Puna e parë ishte të shtoja numrin e rojeve e të vëzhguesve, por edhe ushtaravë të sapoardhur t'ju jepja urdhër të pushonin, sa të mernin veten, që të mos qëndronin kokë më kokë si delet në vathë, por të maskuar e në grupe të vogla, madje edhe në distancë njëri nga tjetri, pasi ua bëra të qartë, se armiku nuk flinte dhe mund të na granatonte e të na qëllonte nga çasti në çast.

Kështu kaluan 30 minuta dhe ne nuk kishim asnjë zhvillim të ri.

Vëzhgova sërisht terrenin përreth me dylbi, me synim për të hetuar ndonjë lëvizje të re të kundërshtarit. Zbulova fortifikatën e tij, në fshatin e parë, aty poshtë. Prej këndeje, në një distancë 300-400 metra, dalloja edhe eprorët serbë të uniformuar e me grada ushtarake, të cilët edhe ata po vrojtonin këndeje nga pozicionet tona. Dy prej tyre, të cilët po shihnin në drejtimin tonë, herëpashere edhe shënonin në blloqet që i kishin me vete. Siç dukej ata dy po përpiqeshin të përcaktonin koordinatat tona.

„O Arber, si do t'ja bëjmë nëse ngelim pa municion dhe pa përforcime? Na duhet patjetër municion, bukë e ushqim. Ata vetëm na premtojnë e ja, kaluan plot 14 orë dhe asgjë konkrete nuk u realizua. Çfarë do të pinë e do të hanë ushtarët, mos vallë premtimet e tyre? Me premtime boshe nuk motivohet ushtari për luftë. Si i bëhet nëse ushtarët e humbin durimin?”

Dëshpërimi e zhgënjimi i Ahmetit dhe i Arsimit për komandën eprore, ishin të ligjshëm dhe real.

„Vëllezër, përtej se të vdesim, s'kemi se ku të shkojmë! Jemi bashkë! Ju lus për herën e fundit të mbahemi, t'a ruajmë njëri-tjetrin, t'i mbledhim forcat, t'i bashkojmë vullnetet e mira dhe t'a luftojmë armikun. Për këtë qëllim jemi këtu, atëhere të përpiqemi t'a vazhdojmë misionin, të cilin ne e kemi nisur për këtë luftë çlirimtare. Edhe pse qenkemi të rrethuar me gënjeshtarë, të pakualifikuar e të pashpirt, ne do të gjejmë një shteg për t'ia dalë mbanë!”

„Të kujtohet dje, more Arber, se si para syve tanë e të ushtarëve të uritur e të etur deri në alivanosje, shefat tanë shqipfolës piqnin e hanin suxhukë e pinin si të babëzitur raki, si të festonin nisjen tonë për në dasëm?!”, ndërhyri Arsimi me plot të drejtë, me mllëf e zemëratë.

„Arsim, më ngjan se ne të gJORËT edhe do të vdesim pa pasur mundësi t'i spjegojmë hallet tona e lëre më t'i rregullojmë këto! ... Të lutem njëherë e përgjithmonë, njëherit po t'a rikujtoj se eprorët e mi, pa kurrfarë arsyeje më burgosën mua në Burrell! E kam ndier qartë se ata ndiheshin inferiorë

përballë përgatitjes sime ushtarake, ndaj edhe përpiqeshin të më mbanin sa më larg shtabit të eprorëve të 'lartë', duke m'a lënë mua qëllimisht detyrën e eprorit të një toge! Pra, është koha e të ligut! Mbretëron kohë anarkie! Këta s'ka kush t'i kontrollojë dhe s'japin askund llogari! Këta nuk e duan njeriun serioz, kapacitetin e talentin, sepse atëhere edhe duhet t'i gasen punës! Këta s'janë punëtorë, por karrieristë e përtacë. Ndërsa nesër, ju betohem, se të njëjtit do të përpiqen, që masa e gjerë t'i shohin me syrin tjetër këto skena e aktivitete të tmerrshme, mbase duke na bërë edhe neve përgjegjës për këto! Këta nuk mendojnë se historia jonë tani e tutje edhe do të shkruhet. Sepse unë që këtu mbaj ditar, kam arkivin ushtarak pranë vetes e nesër, nëse njëri nga ne ia mbërrin lirisë, ky ditar do të shkojë në dorën e popullit. Rëndësi ka sot për neve të mos iu dorëzohemi vështirësive dhe të shohim përpara”, iu përgjigja Arsimit, duke u munduar që sadopak t'a motivoja për qëllimin dhe misionin tonë të shenjtë.

Orët kalonin pa ngjarje për t'u shënuar.

Shpresonim se mëngjesi i të së nesërme do t'i ndryshonte gjërat, përndryshe, për shumicën nga ne, ky mundte të ishte edhe gjumi i fundit!

Duke e thithur ajrin e freskët të pyllit, të përzier me erë baroti nga shpërthimet e deritanishme, ne po e bënim gjumin e parë në folenë e luftës! Unë, mbas shtatë viteve, po e bëja një sy gjumë mbi tokën e Kosovës ... Eh, si qenka jeta! ... Natën e mirë nga lufta në Pashtrik!

Nisi të agojë. Siç edhe ishim marë vesh, komandanti i rojeve na zgjoi në kohë, akoma pa zbardhur mirë. Po fillonte një ditë e re! Ishte e enjte, data shënonte 27 maj 1999. Po nisnin të zgjoheshin edhe ushtarët. Sapo i hapnin sytë, ju kujtohej se ku ishin. Zogjtë po cicëronin. Edhe pylli nisi të zgjohej nga gjumi aty në Pashtrik.

Me mushkëritë e ndjeshme dhe kokën e rënduar, përpiqesha të përmbahesha, t'a ngrija trupin e t'i mbaja pajisjet ushtarake. Shihja një ushtar se si po i lëpinte disa gjethe të mbushura me vesë, një tjetër e pa këtë dhe po e lëpinte edhe ai barin e njomur nga lagështia e mëngjesit dhe ajrit të atyshëm, i cili ishte i ngarkuar me piroteknikë!

Sanitareve iu ishin harxhuar tabletat për dhembjen e kokës! Po si t'a merje vallë tabletën, kur as një pikë ujë nuk e kishe?!

Ky ishte testi i leximit nga libri im “Lisi i gjakut” (“Kur fjalët vrasin”).

Eprori i lig është në gjendje që të shkrijë një armatë të tërë, vetëm që nesër të marrë për vete medaljen e gjakosur me gjakun e dëshmorit ...

Ushtarët e UÇK-së -, të cilët u morën dhe u mobilizuan me nxitim dhe u dërguan në vijën e frontit, pa u stërvitur siç duhet -, e dhanë jetën më shumë nga papërgjegjshmëria e eprorëve tanë se sa nga zotësia e armikut e për këtë një ditë, siç edhe e kam thënë, ata duhet të japin llogari! Ashtu siç një ditë, do të japin llogari deri më një, edhe eprorët tanë të "lartë" të Pashtrikut, të cilët na hodhën në luftë pa bukë dhe pa ujë e me municion të pamjaftueshëm, i cili sa po vinte duke u shterur.

Nëse fragmenti i leximit ka arritur të zgjoj kureshtjen dhe interesimin tuaj, për mbështetjen tuaj në veprën time letrare unë do të isha shumë i lumtur. Libri mund të porositet në Buchhandel.de (Amazon, Thalia).

Unë, si shkrimtar dhe luftëtar i lirisë, jam kronist, dëshmitar, jo misionar i një botëkuptimi të caktuar. Me nderime dhe respekt, ju falemnderoj.

Autori


Arber Shabanaj

Autor Arber Shabanaj widmet sich den kleinen Dingen des Lebens

Der Lyriker lässt Gefühle in seinen zwei neuen Werken lebendig werden.

Von Tanja Heil

Sorgfältig sind die Worte gesetzt. Manchmal ein wenig umständlich in dem Bemühen, alles ganz genau zu schildern. Denn Arber Shabanaj hat einen Blick für Details, widmet sich den Kleinigkeiten des Lebens. Gleich zwei Bücher hat der Wuppertaler Autor jetzt gleichzeitig in der Edition Garamond herausgebracht: den Gedichtband „Exkursion der Lyrik“ und „Schuhe der Scham“ mit Kurzgeschichten. „Ich hatte beide Projekte kurz hintereinander abgeschlossen“, erklärt Shabanaj. Drei Verlage hatten an den Werken aus zwei Jahrzehnten Schaffenszeit Interesse. Der Lyriker wählte den umtriebigen österreichischen Garamond-Verlag, der sich jungen Autoren widmet.

In einheitlichem Hellblau kommen die beiden Bände nun daher. Viele Hoffnungen, Wünsche und Ängste hat der gebürtige Albaner darin verarbeitet, der vor der Gewalt in seiner Heimat nach Deutschland geflüchtet war. Es ist erstaunlich, wie feinfühlig Shabanaj mit der erst im Erwachsenenalter gelernten deutschen Sprache umgeht.

„Der Leser soll schmunzeln, sich amüsieren und sieht sich schließlich doch einem schwerwiegenden Problem gegenüber.“

Arber Shabanaj

Durch die Gedichte weht oft eine Schwermut, die aus der Erinnerung an Verluste kommt. Freiheit, die genommen wurde, Träume, die geplatzt sind. Auch die Liebe findet ihren Platz, doch häufiger bringt

Shabanaj schreckliche Erlebnisse in eine literarische Form. Die Geschichten spielen zum Teil in Wuppertal und bleiben doch fremd. Der kulturelle Hintergrund Arber Shabanajs mischt sich mit seinen Erlebnissen in Deutschland, etwa in der Bürokratie. Eindringlich schildert der Elberfelder die tiefe Kluft zwischen armen und reichen Familien. Er hinterfragt verschiedene Auslegungen von Moral und Anstand, von Scham und Selbstverständnis. Tiefe Gefühle, gerade junger Menschen, lässt Shabanaj in seinen Erzählungen lebendig werden. Und er verarbeitet seine Erfahrungen als Poet in einer Welt, die von



hoher Literatur nicht viel wissen will. „Der Leser soll schmunzeln, sich amüsieren und sieht sich schließlich doch einem schwerwiegenden Problem gegenüber“, erklärt Shabanaj.

» „Schuhe der Scham“ (19,80 Euro) und „Exkursion der Lyrik“ (16,80 Euro) sind in der Edition Garamond erschienen und können über den Buchhandel bestellt werden. jembiter-liber.de

WZ DONNERSTAG, 26. OKTOBER 2017

Çmimi „Pavarësia“ 2022

Friedberg, më 24.11.2022

Të nderuar miq të letërsisë,

kam nderin t'ju prezentoj poezinë time - e cila fitoi 'Çmimin "Pavarësia" 2022' - me titull "Qielli i natës dhe Ylli".

Unë çuhem Arber Shabanaj, i lindur më 08 mars të vitit 1970 në Gjakovë. Rrugën time drejt letërsisë e kam nisur me poezinë. Që në gjimnaz e më pas - përgjatë studimeve në universitet - poezia m'u bë shoqëruese dhe kështu, duke ecur, ne nuk iu ndamë më njëri-tjetrit.

Punën dhe veprimtarinë time të palodhshme për të drejtat dhe lirinë e popullit tim, i trajtoja si diçka krejtësisht legjitime dhe që në kohën e regjimit të egër sllav kërkoja liri krijimi. Unë nuk kam qenë disident! Atë që më ka thënë zemra e kam shprehur. Kuptohet se edhe për këtë organet e dhunëshme qeveritare dhe policore sllave, të cilat ishin të instaluar në Kosovë, më maltretuan sidomos në Verën e Vitit 1991 pa fije mëshire fizikisht dhe, për të kuruar plagët dhe shpëtuar jetën time, u përndjeka me dhunë nga Kosova dhe u detyrova të emigroi politikisht në Gjermani, ku unë jetoj dhe punoj. Libra unë shkruaj sikurse në gjuhën Shqipe poashtu edhe në atë Gjermane dhe veprat e mia mundën të porositen përmes „Buchhandel.de“ (Amazon, Thalia):

„Das Gericht des gelobten Rechtsstaates“, „Die vorgespilte Gerechtigkeit“, „Der Befreiungskrieg, wie ich ihn erleben musste“, „Die Glocken der Stille“ dhe vepra të tjera të mia pothuaj i begatojnë vitrinat e literaturës gjermane.

Mendoj se shkrimtari kur krijon, nuk gjykon se po krijon që të bëhet statistikë për një gjeneratë apo një tjetër. Letërsia të krijuesi nis si art i pavarur dhe krejtësisht individual. Shkrimtarët e mëdhenj, jo vetëm në letërsinë shqipe, por edhe atë botërore, kanë ndihmuar në diversitetin dhe pasurimin e gjuhës, traditës, kulturave kombëtare, pra ju kanë dhënë identitet kombëtar prej nga vijnë dhe në këtë kontekst ju kanë bërë shërbim të madh vendeve të tyre ...

Shkrimtari i vërtetë është gjithnjë në konflikt me konvencionet e epokës së vet. Edhe kjo poezi vjen si një polifoni e vërtetë, e përsosur dhe bën jehonë të madhe, për shkak të tematikës së mprehtë, trajtimit dhe mpleksjes së shumë elementëve.

Promovimi i gjithë veprës sime, veçanërisht triumfi i 'Çmimit "Pavarësia" 2022', është një tjetër ditë e bukur e nëntorit të librit, që këtë herë u ndal në Stuttgart. Një takim fantastik me miq të mi dhe miq të letërsisë, me intelektualë e personalitete.

Më nderuan me vendimin e tyre personalitetet e Komisionit vlerësues të Shoqatës Pavarësia. Nën drejtimin e shkëlqyer të zotit Xhevdet Sylja.

Unë jam shumë mirënjohës për vendimin tuaj, njëherit për punën e mrekullueshme të institucionit tuaj kulturor, i cili u

kujdes fisnikërisht për këtë aktivitet. Në odën e gjerë të Shoqatës Pavarësia, në vjeshtën e mesme të letërsisë, me krushq nga bota e letërsisë dhe e artit, për të kurorëzuar krijimtarinë time. Faleminderit, i nderuari zoti Xhevdet Syla, që më bëre pjesë të programit tënd.

Me respektin tim sublim, ju uroj ç'do të mirë,



Arber Shabanaj
86316 Friedberg-Bayern
0151 58 332 502
as-arber@t-online.de

Në vazhdim më lejoni t'ju lexoj poezinë e sipërpërmendur - fituese -, e cila titullohet „Qielli i natës dhe Ylli“

QIELLI I NATËS DHE YLLI

*Qielli i madh, plot me elemente për t'u admiruar,
një përmasë hapësire, një Tokë e shtrenjtë
dhe ne, shumë largë për t'u reformuar,
të vendusur - shumë afër - për t'u larguar shpejtë.
Aty ra një Yll! Dhe dëshira e jonë për të,
jehoi nga vështrimi i tronditur lartë,
e shoqëroi urgjentisht nën t'njëjtin zë:*

*„Çfarë ka filluar
dhe çfarë ka kaluar?“*

Shëndriti Anton Çeta:

*„Jemi pak për t'u vrarë,
për një pikë uji a për një gardh në arë
dhe nëse e duam jetën,
në trekëmbësh t'a çojmë 'Mesjetën'!“*

*O ju lugina të gjëra, o ju lartësi,
o pyll i bukur, i gjelbëruar për mrekulli,
ti epshi i gjakut dhe ju hidhërimet e mia,
qëndroni nderues para veprave të tija!
Se ku është mendja e Antonit të artë,
atje vdes vdekja,
atje nis jeta, atje është besa,
është shpresa,
është rinia,
është plaku e fëmija.
O Anton Çeta, o thesar,
Anton mrekullia,
ku je ti,
aty është i gjithë populli Shqiptar!*



Autor/i: Arber Shabanaj

Vita artistike

Të nderuar miq të letërsisë,

unë çuhem Arber Shabanaj, i lindur më 08 mars të vitit 1970 në Gjakovë. Rrugën time drejt letërsisë e kam nisur me poezinë. Që në gjimnaz e më pas - përgjatë studimeve në univerzitet - poezia m'u bë shoqëruese dhe kështu, duke ecur, ne nuk iu ndamë më njëri-tjetrit.

Punën dhe veprimtarinë time të palodhshme për të drejtat dhe lirinë e popullit tim, i trajtoja si diçka krejtësisht legjitime dhe që në kohën e regjimit të egër sllav kërkoja liri krijimi. Unë nuk kam qenë disident! Atë që më ka thënë zemra e kam shprehur. Kuptohet se edhe për këtë organet e dhunëshme qeveritare dhe policore sllave, të cilat ishin të instaluar në Kosovë, më maltretuan sidomos në Verën e Vitit 1991 pa fije mëshire fizikisht dhe, për të kuruar plagët dhe shpëtuar jetën time, u përndjeka me dhunë nga Kosova dhe u detyrova të emigroja politikisht në Gjermani, ku unë jetoj dhe punoj. Libra unë shkruaj sikurse në gjuhën Shqipe poashtu edhe në atë Gjermane dhe veprat e mia munden të porositen përmes „Buchhandel.de“ (Amazon, Thalia):

„Das Gericht des gelobten Rechtsstaates“, „Die vorge-spielte Gerechtigkeit“, „Der Befreiungskrieg, wie ich ihn erleben musste“, „Die Glocken der Stille“ dhe vepra të tjera të mia pothuaj i begatojnë vitrinat e literaturës gjermane. Falënderime të përzemërta.

Arber Shabanaj

Katalog

2022/2023



Arber Shabanaj & jembiter-liber
Schriftsteller/Writer/Shkrimtar

Arber Shabanaj

86316 Friedberg

Mobiltelefon: 0151 58 332 502

E-Mail: as-arber@live.de

Internet: www.jembiter-liber.de

